

# EPOKA ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XVIII, nr. 5629  
E enjte, 15 nëntor 2018  
çmimi 0.40 €

## Veseli takohet me Ahtisaarin, flasin për dialogun Kosovë - Serbi



FAQE 2

Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
www.awr-abbruch.de

### AKTUALE

**GJATË PERIUdhËS  
JANAR-TETOR NGA SKEMAT  
E RIINTEGRIMIT PËRFITUAN  
2 843 PERSONA** F. 6

**SHKARKOHET BORDI I  
STACIONIT TË AUTOBUSËVE,  
CAKTOHEN ANËTARËT E RINJ** F. 6

**RISHIKIMI I LIGJIT PËR  
SHËNDETËSI DHE I ATIJ PËR  
SIGURIME SHËNDETËSORE,  
AFËR FINALIZIMIT** F. 7

### EKONOMI

**HARADINAJ: KOSOVA KA  
KRIJUAR INFRASTRUKTURË  
LIGJORE PËR T'I  
TRANSFERUAR PRODHIMET  
NË TREGJET E HUAJA** F. 8

**ALARMOHET PËR VIGJILENCË  
NË HULUMTIMIN E  
AKSIDENTEVE TË LEHTA  
NË KOMUNIKACION** F. 9

### KULTURË

**GJUHA DHE  
ASIMILIMI  
NACIONAL** F. 13

Hasan MUJAJ



### SPORT

**KOSOVA PËRFUNDON  
STËRVITJEN E TRETË,  
SOT NISËT PËR MALTË** F. 18

## FLET PËR "EPOKËN E RE", IBRAHIM GASHI

# KOSOVA NUK E KA LUKSIN TA KUSHTËZOJË BE-në

Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Ibrahim Gashi, ka shprehur skepticizëm se Kosova do të mund ta kushtëzojë dialogun Kosovë - Serbi me procesin e liberalizimit të vizave. Në

këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se mosdhënia e liberalizimit të vizave do të ndikojë në zbehjen e besimit të qytetarëve të Kosovës në vlerat e BE-së

por, sipas tij, Kosova nuk e ka luksin ta kushtëzojë BE-në. Gashi ka vlerësuar se tani BE-ja e ka humbur argumentin e vet për mosliberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës

**Gjykata e  
Apelit  
konfirmon  
pafajësinë e  
Limajt në  
rastin  
'Bellanica'**

FAQE 7



VLORA ÇITAKU

## Çitaku: Për ushtrinë Kosova nuk dialogon me Serbinë

FAQE 2

## Kosova shton lobimin për anëtarësim në Interpol

Liderët shtetërorë kanë shtuar përpjekjet për të lobuar në vende të ndryshme për anëtarësimin e Kosovës në Interpol. Kryeparlamentari Kadri Veseli ka qëndruar të mërkurën për vizitë në Finlandë, ku ka marrë mbështetjen e zyrtarëve finlandezë për anëtarësimin e

Kosovës në organizatën ndërkombëtare të sigurisë, Interpol. Edhe kryeministri Ramush Haradinaj në fund të javës do të shkojë në Austri për të lobuar që vendi ynë të bëhet pjesë e Interpolit. Edhe presidenti Hashim Thaçi ka bërë me dije se ka marrë konfirmimin e



Turqisë e cila do të angazhohet te 17 vende për përkrahje të anëtarësimin të Kosovës në Interpol

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Kurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
www.princesha-ks.com

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
Pruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Veseli takohet me Ahtisaarin, flasin për dialogun Kosovë - Serbi

PRISHTINË, 14 NËNTOR (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, është duke qëndruar për një vizitë zyrtare në Finlandë. Në kuadër të kësaj vizite kryeparlamentari Veseli është takuar të mërkurën me ish-presidentin e Finlandës dhe ish të dërguarin special për statusin e Kosovës, Marti Ahtisaari, me të cilin ka evokuar kujtime nga shpallja e pavarësisë së vendit tonë si dhe ka biseduar për dialogun me Serbinë. "Pata kënaqësinë ta takoj presidentin

Marti Ahtisaari. Evokuam kujtime nga puna e tij që çoi në shpalljen e Kosovës shtet i pavarur dhe sovran, një ëndërr dhe përpjekje e gjatë e popullit tonë. Ne jemi krenarë që Kosova është bërë shembull i demokracisë për shumë vende. Me presidentin Ahtisaari shkëmbyem shumë mendime për të ardhmen e Kosovës dhe këshillat e tij janë gjithmonë të mirëseardhura", ka bërë me dije Veseli pas takimit me Ahtisaarin. Veseli ka theksuar se në këtë fazë

Kosova është e përkushtuar ta vazhdojë dialogun me Serbinë, për t'i përmbyllur përgjithmonë çështjet e hapura mes dy vendeve dhe për të ecur si dy vende sovranë në rrugën e integrimeve evropiane. "Kushtetua e Kosovës, që buron nga propozimi i presidentit Ahtisaari, është garantuese e fortë e lirisë së qytetarëve tanë, pa dallim, dhe mbrojtja e kësaj kushtetute do të jetë angazhimi ynë i përhershëm, në çdo fazë", ka deklaruar Veseli.



# Çitaku: Për ushtrinë Kosova nuk dialogon me Serbinë

Ambasadorja e Kosovës në Uashington, Vlora Çitaku në seancën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së ka thënë se për themelimin e ushtrisë Kosova nuk do të dialogojë me Serbinë dhe kjo çështje do të përfundojë së shpejti. Ajo ka folur edhe për dialogun, duke thënë se Kosova vazhdon përbushjen e marrëveshjeve të arritura në Bruksel

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Ambasadorja e Kosovës në Uashington, Vlora Çitaku, ka thënë se vendi ynë ka bërë progres të madh që nga shpallja e pavarësisë dhe se tash UNMIK-u nuk e ka më rolin paqeruajtës, andaj do të ishte më e dobishme që resurset e kësaj organizate të shfrytëzohen për zgjidhjen e krizave tjera nëpër botë. Ajo gjatë fjalës së saj në Këshillin e Sigurimit të OKB-së për Kosovën kërkoi nga vendet anëtare të këtij institucioni t'i referohen vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë se Kosova nuk ka shkelur asnjë ligj kur ka shpallur pavarësinë dhe se ky realitet është i pakthyesëm. "Këto sesione këtu nuk i ndih-

mojnë paqes dhe dialogut dhe fatkeqësisht ky vend këtu është duke u keqpërdorur dhe është shndërruar në teatër", u shpreh ai.

Diplomatja kosovare ka folur edhe rreth anëtarësimit të Kosovës në Interpol, duke thënë se nuk mund të pritët nga vendi ynë t'i luftojë krimet pa qenë pjesë e këtij institucioni të rëndësishëm.

"Kosova nuk duhet të jetë një vrimë e zezë mes kontinentit evropian. Kemi dëshirë të ndihmojmë jo vetëm Kosovën, por edhe rajonin dhe Evropën për të qenë më të sigurt. Sa i përket policisë, OKB-ja duhet të mburret se vetë ka ndihmuar të themelojë Policinë e Kosovës



dhe Kosova ka ndihmuar në parandalimin e kompleteve terroriste", u shpreh ajo.

Sipas saj, për themelimin e ushtrisë nuk do të dialogohet me Serbinë dhe kjo çështje do të përfundojë së shpejti. Ndërsa shtoi se themelimi i ushtrisë nuk paraqet shkelje të rezolutës 1244 të KS të OKB-së.

Duke folur për dialogun, ambasadorja Çitaku tha se

Kosova vazhdon përbushjen e marrëveshjeve të arritura në Bruksel, por Serbia nga ana e saj ka dështuar në përbushjen e marrëveshjes së energjisë, e cila i kushton Kosovës me miliona në vit, madje Beogradi zyrtar ka shkelur CEFIA-n, andaj tatimi i vendosur prej 10 për qind ndaj mallrave serbe si i tillë ka qenë i pashmangshëm.

"Dialogu paraqet të vetmin shteg

përpara për të dyja vendet, por është e rëndësishme që të pajtohemi se çfarë është ky dialog. Dialogu është për paqe, pajtim dhe njohje reciproke, dhe si i tillë do të ketë kuptim dhe do të prodhojë rezultate vetëm nëse ne vendosim të flasim sinqerisht në lidhje me proceset në Bruksel. Fqinjët tanë duhet të na trajtojnë si qenie të barabarta dhe duke njohur të gjitha të drejtat tona", tha ambasadorja Çitaku.

Ajo ka përmendur se Fatmir Limaj është liruar dy herë nga Gjykata e Hagës, duke dëshmuar kështu pafajësinë e luftës çlirimtare të Kosovës.

Seanca e KS të OKB-së kushtuar situatës në Kosovë, e para pas gjashtë muajsh, ishte planifikuar me iniciativën e Kinës, e cila mori përsipër Këshillin e Sigurimit më 1 nëntor.

Seanca e mëparshme e Këshillit të Sigurimit të OKB-së për Kosovën u mbajt më 18 maj dhe një pauzë gjashtë mujore ishte rezultat i kundërshtimit të ShBA-së, Britanisë dhe Francës për të diskutuar çështjen çdo tre muaj, siç ishte rasti në 19 vjetet e fundit.

## Mogherini: Viti 2019 do të jetë i suksesshëm për Shqipërinë



BRUKSEL, 14 NËNTOR - Në Bruksel është mbajtur një konferencë e përbashkët për mediet nga ministri i Jashtëm shqiptar Ditmir Bushati, eurokomisionari për zgjerimin Johannes Hahn dhe përfaqësuesja për Politikë të Jashtme në BE, Federica Mogherini.

E para që mori fjalën ishte Mogherini, e cila tha se viti 2019 do të jetë një vit ku do të shënohen suksese nga Shqipëria.

"Shqipëria vazhdon të luajë një rol konstruktiv në rajon. Kemi

qenë të vendosur për t'i dhënë prioritet operacioneve në fushën e sigurisë. Marrëveshja mes vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Evropës është strategjia me të cilën po ecin vendet. Ne do të vazhdojmë të punojmë me Shqipërinë për t'i plotësuar të gjitha kushtet. Ne mbetemi të vendosur që 2019 të jetë vit i suksesshëm për Shqipërinë ashtu siç dëshirojnë qytetarët shqiptarë", tha Mogherini. Ndërkohë ministri Bushati

theksoi se në kuadër të procesit të integritetit, qeveria "Rama" është e hapur dhe e gatshme për dialog me forcat e tjera politike. "Gjatë diskutimeve në takimin e 10-të Stabilizim-Asoocimit, dhamë mesazhin për të mbajtur hapur derën për bashkëpunim me forcat politike. Jemi pro reformave. Në qershorin e 2019-ës bashkë me KE-në dhe vendet e BE-së të punojmë të gjithë së bashku, që këtë histori ta kthejmë në histori suksesi", tha Bushati.

# Kosova shton lobimin për anëtarësim në Interpol

Liderët shtetërorë kanë shtuar përpjekjet për të lobuar në vende të ndryshme për anëtarësimin e Kosovës në Interpol. Kryeparlamentari Kadri Veseli ka qëndruar të mërkurën për vizitë në Finlandë, ku ka marrë mbështetjen e zyrtarëve finlandezë për anëtarësimin e Kosovës në organizatën ndërkombëtare të sigurisë, Interpol. Edhe kryeministri Ramush Haradinaj në fund të javës do të shkojë në Austri për të lobuar që vendi ynë të bëhet pjesë e Interpolit. Edhe presidenti Hashim Thaçi ka bërë me dije se ka marrë konfirmimin e Turqisë e cila do të angazhohet të 17 vende për përkrahje të anëtarësimin të Kosovës në Interpol

kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit. Kryetarja e Parlamentit të Finlandës, Paula Risikko, ka konfirmuar mbështetjen për Kosovën në procesin e liberalizimit të vizave, anëtarësimin në Interpol dhe në procese të tjera integruese. Ajo e ka vlerësuar progresin e bërë në Kosovë dhe ka theksuar gatishmërinë e Finlandës që të thellohet bashkëpunimi me Kosovën.

Veseli e Risikko kanë theksuar nevojën për thellimin e bashkëpunimit në mes të Kosovës dhe Finlandës, në veçanti në fushën e ekonomisë dhe edukimit. Në kuadër të kësaj vizite Veseli ka marrë mbështetjen e Finlandës edhe për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës. Për të lobuar për anëtarësimin e Kosovës në Interpol edhe kryeministri Ramush Haradinaj në fund të javës do të shkojë për vizitë zyrtare në Austri, me ç'rast pritet të takohet nga kancelari austriak Sebastian Kurz. Gjatë kësaj vizite Haradinaj do ta marrë përkrahjen e Austrisë edhe për procesin e liberalizimit të vizave. "Do të jem në Vjenë në fund të kësaj jave. Edhe një herë do ta mundësinë të

bisedoj me kancelarin Kurz për procesin e liberalizimit të vizave dhe për anëtarësimin e Kosovës në Interpol", ka deklaruar Haradinaj.

Ditë më parë kryeministri Ramush Haradinaj ka marrë një letër nga kancelarja e Gjermanisë, Angela Merkel, e cila i ka konfirmuar atij përkrahjen e fuqishme të Gjermanisë për anëtarësimin e Kosovës në Interpol. "Këtë e konfirmon letra nga kancelarja Angela Merkel, të cilën e pranova përmes ambasadorit Christian Heldt. Mbështetja e fuqishme e Gjermanisë mike për anëtarësimin e Kosovës në Interpol vjen në një moment kyç për konsolidimin ndërkombëtar të vendit tonë. Kancelarja Merkel vë në pah se ky akt do ta fuqizojë integrimin e Republikës së Kosovës në bashkësinë ndërkombëtare dhe është në shërbim të përmirësimit të bashkëpunimit në fushën e sigurisë dhe hetimit të krimit transnacional. Thellësisht mirënjohës kancelares Merkel dhe shtetit gjerman për mbështetjen e vazhdueshme", është shprehur Haradinaj.

Ndërsa presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, në kuadër të shënimit të 100-vjetorit të Luftës së Parë Botërore, është takuar me shumë udhëheqës botërorë, përfshirë edhe presidentin e Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, nga i cili ka marrë mbështetje për anëtarësimin e Kosovës në Interpol. Thaçi ka thënë se homologut turk i ka dhënë një listë të shteteve që Turqia të llojë për këtë çështje. "Jemi takuar me Erdoganin. Ia kemi dërguar një listë me 17 shtete që ato vende t'i amortizojë të na ndihmojnë të votojnë pro anëtarësimin të Kosovës. Është zotim i tij që të ndihmojë dhe të angazhohet maksimalisht në këtë çështje dhe për këtë e falënderoj", ka theksuar Thaçi, duke shtuar se për anëtarësimin e Kosovës në Interpol ka marrë përkrahjen edhe të liderëve të tjerë botërorë. Aplikimin e parë për anëtarësim në Interpol Kosova e pati bërë në vitin 2010 dhe më pas e kishte përsëritur pesë vjet më vonë. Në vitin 2017 Kosova kishte hequr dorë nga kërkesa për pranim në Interpol për shkak të mbështetjes së pamjaftueshme për anëtarësim.

**EPOKA  
ERE**

Shqipe HETEMI

**PRISHTINË, 14 NËNTOR** - Drejtuesit e institucioneve të Kosovës kanë shtuar lobimin në kryeqendrat evropiane për pranimin e Kosovës në organizatën ndërkombëtare të sigurisë, Interpol. Prandaj në Asamblenë e Përgjithshme të Interpolit, e cila këtë vit do të mbahet në Dubai, nga 18 deri më 21 nëntor, Kosova pret përkrahje të gjerë për t'u bërë pjesë e kësaj

organizate.

Kryeparlamentari Kadri Veseli ka qëndruar të mërkurën për vizitë në Finlandë, ku ka marrë mbështetjen e zyrtarëve finlandezë për anëtarësimin e Kosovës në Interpol. Këtë përkrahje Veseli e ka marrë nga kryetarja e Kuvendit të Finlandës, Paula Risikko dhe nga parlamentarë të tjerë finlandezë. Kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, ka kërkuar nga Finlanda që ta përkrahë Kosovën për anëtarësim në Interpol si një hap tejet i rëndësishëm për luftën



## Hoti thotë se partitë politike duhet të bisedojnë për ta shpërndarë Kuvendin



**PRISHTINË, 14 NËNTOR (ER)** - Shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka ftuar të gjitha subjektet politike që të ulen dhe të bisedojnë për ta shpërbërë

Kuvendin e Kosovës. Në profilin e vet në "Facebook", Hoti ka shkruar se të mërkurën kanë dështuar shumica e mbledhjeve të komisioneve parlamentare për shkak të

mungesës së deputetëve të koalicionit qeverisës. "E udhës do të ishte që partitë politike të ulen së bashku për ta shpërbërë Kuvendin. Kosova meriton të ketë institucione

legjitime, të besueshme, që janë në krye të detyrës. Kjo formë e qeverisjes duhet të mbarojë sepse po dëmton çdo proces në vend", ka shkruar Hoti.

Flet për "Epokën e re", Ibrahim Gashi

# Kosova nuk e ka luksin t



Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Ibrahim Gashi, ka shprehur skepticizëm se Kosova do të mund ta kushtëzojë dialogun Kosovë - Serbi me procesin e liberalizimit të vizave. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se mosdhënia e liberalizimit të vizave do të ndikojë në zbehjen e besimit të qytetarëve të Kosovës në vlerat e BE-së por, sipas tij, Kosova nuk e ka luksin ta kushtëzojë BE-në. Gashi ka vlerësuar se tani BE-ja e ka humbur argumentin e vet për mosliberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës

izimit ndikon në zbehjen e besimit të kosovarëve në vlerat e proklamuar humane të BE-së. Në fakt, BE-ja e ka humbur argumentin për mosliberalizimin e vizave për Kosovën", ka thënë Gashi.

Ai ka treguar se edhe nëse të gjithë qytetarët e Kosovës do të lëviznin nëpër Zonën Shengen nuk do të ndryshonte asnjë ekuilibër brenda BE-së. "Ajo ka futur në gjirin e vet, përmes liberalizimit, dhjetëra miliona ukrainas dhe moldavianë dhe po pengon, pa ndonjë arsytim të argumentuar, 1.5 milion kosovarë, të cilët, edhe po të lëviznin të gjithë drejt BE-së, nuk do ta ndryshonin shumë asnjë ekuilibër brenda BE-së", është shprehur Gashi, duke shprehur skepticizëm se Kosova këtë vit do të ketë ndonjë vendimmarrje rreth liberalizimit të vizave për Kosovën.

Sipas tij, arsyet e disa vendeve skeptike janë të paqëndrueshme. "Ndonjë arsytim shumë të qëndrueshëm për mosheqjen e vizave ndaj kosovarëve nuk e kemi dëgjuar nga Brukseli. Janë, si duket, shtetet e zhvilluara të Evropës të cilat janë sfiduar nga emigracioni dhe vala e refugjatëve të cilat prolongimin e liberalizimit të vizave për kosovarët e shohin në funksion të përballimit të kësaj sfide që, për mendimin tim, është arsytim i paqëndrueshëm. Edhe forcimi i të djathtës në disa shtete të fuqishme të BE-së mund të interpretohet si arsye për ngadalësimin, madje edhe pengimin e liberalizimit për kosovarët", është shprehur Gashi.

Në këtë intervistë, Gashi ka folur edhe për pjesëmarrjen e Kosovës në ceremoninë e 100-

vjetorit të mbarimit të Luftës së Parë Botërore. Duke folur për privilegjin që protokollit francez i kishte bërë presidentit Thaçi në këtë ceremoni, duke e vendosur të ulet pranë liderëve të shteteve më të fuqishme të botës, Gashi ka thënë se ishte një trajtim i rëndësishëm që iu bë Kosovës me këtë rast. "Është çështje ekskluzive e protokollit të shtetit pritës të cilën unë nuk mund ta komentoj, edhe për faktin se nuk kam ndonjë informacion më shumë dhe nuk dua të spekuloj. Sigurisht se një trajtim i tillë i presidentit Thaçi është i rëndësishëm për shtetin që ai përfaqëson, pra Kosovën", ka thënë Gashi.

**"Epoka e re":** Profesor, Kosova ishte pjesë e ceremonisë së 100-vjetorit të mbarimit të Luftës së Parë Botërore. Për më tepër, protokollit francez ishte

**EPOKA E RE** **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Ibrahim Gashi, nuk beson se Kosova është në pozicion që ta kushtëzojë dialogun Kosovë - Serbi me procesin e liberalizimit të vizave. Ai ka thënë se sado që mosdhënia e liberalizimit të vizave ndikon

në zbehjen e besimit të qytetarëve të Kosovës në vlerat e BE-së, Kosova nuk e ka luksin që ta kushtëzojë BE-në. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Gashi ka bërë me dije se BE-ja tanimë nuk e ka asnjë argument që ta refuzojë liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës. "Kosova nuk e ka shumë luksin të kushtëzojë, sado që mosdhënia e liberal-

# ta kushtëzojë BE-në

*Kosovë ishte ai me presidentin rus, Vladimir Putin. Si e keni parë këtë takim?*

**Gashi:** Sigurisht se në ngjarje të tilla të rëndësishme, ku ka pjesëmarrje të gjerë të liderëve botërorë, ekzistojnë mundësitë për të takuar burrështetas, përfshirë edhe liderë të fuqishëm botërorë. Dua të besoj se ato takime të presidentit Thaçi kanë qenë pjesë e agjendës së tij protokollare gjatë rrjedhës së kësaj ngjarje të madhe në Paris, pra të shënimit të 100-vjetorit të mbarimit të Luftës së Parë Botërore. Nuk mund të them nëse ka qenë i paraparë edhe takimi me presidentin Putin.

**"Epoka e re":** Në të gjitha këto takime, sipas presidentit Thaçi, është konfirmuar mbështetja për një marrëveshje të mundshme Kosovë - Serbi. A do të thotë se me këtë përkrahje Kosova do ta ketë më lehtë fazën finale të dialogut me Serbinë?

**Gashi:** Është vështirë të konstatohet se nga këto takime kemi një mbështetje koncensuale ndërkombëtare për arritjen e marrëveshjes përfundimtare Kosovë - Serbi. Tekefundit, gjerat nuk mund të ndodhin aq lehtë siç mund të thuhet. Ka një disonancë (zëra ndryshe) edhe brenda komunitetit ndërkombëtar lidhur me atë se çfarë do të përfshijë dhe si do të duket kjo marrëveshje.

**"Epoka e re":** Këto ditë janë shtuar zërat se Kosova rrezikon ta marrë liberalizimin e vizave, madje edhe kancelari austriak gjatë vizitës në Prishtinë ka bërë me dije se disa vende të BE-së janë skeptikë për këtë proces. Cilat mendoni se janë arsyet e këtij skepticizmi të vendeve anëtare të BE-së?

**Gashi:** Të them të drejtën edhe unë jam shumë skeptik se Kosova do ta marrë liberalizimin këtë vit. Nuk mund të them diçka më shumë mbi arsyet nga ajo që e kemi dëgjuar. Ndonjë arsyetim shumë të qëndrueshëm për mosheqjen e vizave ndaj kosovarëve nuk e kemi dëgjuar nga Brukseli. Janë, si duket, shtetet e zhvilluara të Evropës të cilat janë sfiduar nga emigracioni dhe vala e refugjatëve të cilat prolongimin e liberalizimit të vizave për kosovarët e shohin në funksion të përballimit të kësaj sfide që, për mendimin tim, është arsyetim i paqëndrueshëm. Edhe forcimi i së djathtës në disa shtete të fuqishme të BE-së mund të

interpretohet si arsye për ngadalësimin, madje edhe pengimin e liberalizimit për kosovarët.

**"Epoka e re":** Z. Gashi, si duhet të sillet Kosova karshi këtij skepticizmi? Do të duhej ta kushtëzonte vazhdimin e dialogut Kosovë - Serbi me

*liberalizim të vizave?*

**Gashi:** Kosova nuk e ka shumë luksin të kushtëzot, sado që mosdhënia e liberalizimit ndikon në zbehjen e besimit të kosovarëve në vlerat e proklamuar humane të BE-së. Në fakt, BE-ja e ka humbur argumentin për mosliberalizimin e vizave për Kosovën. Ajo ka

futur në gjirin e vet, përmes liberalizimit, dhjetëra miliona ukrainas dhe moldavianë dhe po pengon, pa ndonjë arsyetim të argumentuar, 1.5 milion kosovarë të cilët, edhe po të lëviznin të gjithë drejt BE-së, nuk do ta ndryshonin shumë asnjë ekuilibër brenda BE-së.

## Faktorët e rrezikut që favorizojnë shfaqjen e diabetit

**PRISHTINË, 14 NËNTOR (ER)** - Në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK-ja) u shënuar të mërkurën Dita Botërore e Diabetit, me moton "Diabeti dhe familja". Me këtë rast u tha se arsyeja e shënimit të kësaj dite është thirrje për aksion për gjithë ata që me kontributin e tyre do t'i përkrahin masat e parandalimit dhe kontrollit të diabetit në Kosovë dhe botë.

Drejtori ekzekutiv i IKShPK-së, Naser Ramadani, ka thënë se në mbarë botën 425 milionë të rritur jetojnë me diabet dhe ky numër pritet të rritet në 642 milionë. Sa i përket regjistrimit populativ për sëmundje kronike jongsjtitëse, ai ka thënë se kjo ka filluar të stabilizohet në vitin 2017, prandaj nga ky regjistër kanë të dhëna vetëm për vitin 2017. "Faktorët e rrezikut që favorizojnë shfaqjen e diabetit janë: trashëgimia, apo personat me histori familjare, moshat mbi 40 vjeç, obeziteti dhe

mbipesha, mungesa e aktivitetit fizik, duhanpirja, tensioni i lartë i gjakut etj", ka thënë Ramadani.

Zëvendësministri i Shëndetësisë, Rustem Musa, ka thënë se Dita Botërore e Diabetit shërben për të punuar së bashku për ngritjen e vetëdijes publike për diabetin, por edhe në funksion të mobilizimit të të gjithëve për parandalimin dhe ballafaqimin me këtë sëmundje që, sipas tij, ka implikime të mëdha shëndetësore, sociale dhe ekonomike, duke marrë parasysh edhe barrën e shpenzimeve për trajtimin dhe pasojat e tjera që diabeti i shkakton. "Ministria e Shëndetësisë do të jetë e përkushtuar të vazhdojë të ofrojë përkrahje për pacientët e prekur me diabet, gjithashtu për profesionistët që merren me trajtimin e kësaj sëmundjeje, duke fuqizuar kapacitetet ekzistuese dhe duke krijuar kapacitete të reja, me qëllim të parandalimit të sëmundjes së diabetit, që do të kishte impakt

të drejtpërdrejtë në rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe mirëqenies së popullatës", ka thënë ai.

Sa i përket mbulimit dhe trajtimit të diabetikëve me terapi, sipas tij, Ministria e Shëndetësisë ka disa vjet që ka krijuar regjistrin e pacientëve insulinë-vartës, që ka rreth 12 000 pacientë, për të cilët sigurohet insulina dhe barnat e tjera anti-diabetike. Drejtoresha e Klinikës së Endokrinologjisë, Venera Berisha, u shpreh se, bazuar në punën e përditshme në Klinikën e Endokrinologjisë, por edhe në qendrat e mjekësisë familjare në tërë Republikën e Kosovës, trendi i rritjes së sëmundjes së diabetit tip 2 është shumë i madh. Lidhur me këtë, ajo ka thënë se kjo formë e diabetit mund të parandalohet në shumicën e rasteve, përmes aktivitetit të rregullt fizik, një diete të shëndetshme dhe promovimit të mjediseve të shëndetshme të jetesës.

*kujdesur që presidenti Thaçi të ulet pranë liderëve të shteteve më të fuqishme të botës, derisa presidentin serb e kishte vendosur në anën tjetër të pjesëmarrësve, gjë e cila shkaktoi reagime të shumta në Serbi. Si njohës i historisë së diplomacisë, çfarë do të thotë për Kosovën një trajtim i tillë?*

**Gashi:** Është çështje ekskluzive e protokollit të shtetit pritës të cilën unë nuk mund ta komentoj, edhe për faktin se nuk kam ndonjë informacion më shumë dhe nuk dua të spekuloj. Sigurisht se një trajtim i tillë i presidentit Thaçi është i rëndësishëm për shtetin që ai përfaqëson, pra Kosovën.

**"Epoka e re":** Gjatë qëndrimit në Paris presidenti Thaçi është takuar me liderët më të fuqishëm botërorë, por takimi që zgjoi reagim të madh në



## BSPK-ja përkrah protestën e sotme të zjarrfikësve

PRISHTINË, 14 NËNTOR (ER) - Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK-ja) nëpërmjet një komunikate për media i ka shprehur përkrahje Sindikatës së Zjarrfikësve lidhur me protestën e paralajmëruar për sot (e enjte) në Prishtinë, me të cilën kërkohet të rregullohet statusi juridik i zjarrfikësve, të sigurohet vija buxhetore dhe të nivelizohen pagat me shërbimet e tjera emergjente,

të kompensohen për punën jashtë orarit, ndërrimin e natës, punën e fundjavës dhe ditëve të festave dhe të kompensohen shërbimet mjekësore nga lëndimet në vendin e punës. Gjithashtu, zjarrfikësit kanë kërkuar të kenë pajisje të duhura për ta kryer punën e tyre ngaqë pajisjet që kanë tash janë tejet minimale dhe çdo ditë rrezikohet siguria dhe shëndeti i tyre në punë. BSPK-ja shpreh

keqardhje për zvarritjet e tilla që i janë bërë kësaj kategorie të punëtorëve në zgjedhjen e çështjeve shumë esenciale që lidhen me të drejtat e tyre nga marrëdhënia e punës si dhe me diskriminimin e deritanishëm që u është bërë zjarrfikësve, ndaj kërkon nga institucionet relevante që sa më shpejt të reflektojnë për përbushjen e kërkesave të kësaj kategorie të punëtorëve.



# Gjatë periudhës janar-tetor nga skemat e riintegritimit përfituan 2 843 persona

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Në Ministrinë e Punëve të Brendshme është mbajtur të mërkurën takimi i grupit për zbatimin e Strategjisë Shtetërore për Riintegrim të Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar. Zëvendësministri i Punëve të

Brendshme, njëherësh koordinatori kombëtar për riintegrim, Izmi Zeka, ka falënderuar të gjithë aktorët që të janë përfshirë në implementimin e strategjisë, për punën që kanë bërë në kuadër të kësaj periudhe raportuese. Ai ka thënë se pa punën e përbashkët do të ishte vështirë të kishin suksese në procesin e riintegritimit, sidomos një strategji me stan-

darde të BE-së. "Buxheti që është ndarë për procesin e riintegritimit ka ndihmuar shumë që të kemi një riintegrim të qëndrueshëm, pavarësisht se nuk i ka përbashkuar të gjitha kërkesat që kanë dalë nga menaxhimi i këtij procesi, megjithatë ka ndihmuar shumë për të pasur riintegrim të qëndrueshëm", ka thënë zëvendësministri Zeka. Ai ka

theksuar se duke parë fillimin e këtij procesi, MPB-ja me angazhim permanent ka bërë që nga një proces krejtësisht i ri për vendin tonë të bëhet sistem funksional falë edhe punës së Departamentit për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, organizatave ndërkombëtare që kanë mbështetur dhe të gjithë aktorët e përfshirë.

Zeka ka folur edhe për sukseset që janë arritur në kuadër të kësaj strategjie. Ai ka thënë se gjatë periudhës janar-tetor në skemat e ndryshme të riintegritimit kanë përfituar gjithsejtë 2 843 persona, prej tyre 2 309 janë përfitues në skemat e riintegritimit të qëndrueshëm. Po ashtu, është bërë certifikimi i zyrtarëve për menaxhim të riskut dhe trajnime të shumta.



## Njazi Thaçi: KEK-u nuk është shkaktari kryesor i ndotjes së ajrit

PRISHTINË, 14 NËNTOR (ER) - Drejtori menaxhues i Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), Njazi Thaçi, ka takuar të mërkurën anëtarët e Komisionit Parlamentar për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, të cilët, së

bashku me kryetarin e Obiliqit, Xhafer Gashi, kanë vizituar termocentralet e KEK-ut. Thaçi ua ka sqaruar deputetëve se është spekulim i madh kur thuhet se KEK-u është shkaktari kryesor i ndotjes së ajrit. "Biseduam për shumë çështje dhe ofruam infor-

macione për çdo pyetje të deputetëve, me theks të veçantë i sqaruar se KEK-u, si gjiganti më i madh energjetik në rajon dhe me vlera të rëndësishme të shtetit, nuk mund ta mohojmë se shkakton ndotje, por është spekulim i madh kur thuhet se

është shkaktari kryesor i ndotjes së ajrit. KEK-u nuk hyn në mesin e ndotësve më të mëdhenj dhe nuk duhet të paragjykohe si i tillë, por duhet të identifikohen shkaktarët e tjerë që në sezonin e dimrit aktivizojnë ngrohjen me thëngjill dhe lëndë të tjera të dje-

gies në mënyrë të pakontrolluar", ka shkruar Thaçi në profilin e vet në "Facebook". Ai i ka informuar deputetët se KEK-u në dhjetëvjeçarin e fundit ka mbyllur ciklin e investimeve të mëdha për përmirësimin e ambientit duke investuar 57 milionë euro.

## Shkarkohet bordi i Stacionit të Autobusëve, caktohen anëtarët e rinj

Prishtinë, 14 nëntor (ER) - Komuna e Prishtinës nëpërmjet një njoftimi për media ka njoftuar se është shkarkuar bordi i Stacionit të Autobusëve

dhe janë caktuar anëtarët e rinj. "Komisioni i Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike 'Stacioni i Autobusëve' ka marrë vendim sot që ta

shkarkojë bordin e kësaj ndër-marrjeje dhe t'i caktojë anëtarët e rinj me qëllim mënyrë që të vazhdohen reformat", është thënë në njoftimin për

media të Komunës së Prishtinës. Anëtarët e rinj të bordit janë: Faton Raçi, Anita Morina Saraqi, Afërdita Sylja Ismaili dhe Fatmir Morina.



Mbahet takimi i Komitetit Drejtues për Shëndetësinë e Kosovës

## Rishikimi i Ligjit për shëndetësi dhe atij për sigurime shëndetësore afër finalizimit

Komiteti Drejtues, në kuadër të detyrave të veta, u zotua ta shtojë dinamikën e implementimit të projektit, në mënyrë që të arrihen të gjitha rezultatet e parapara, si ndikim direkt në përmirësimin e shërbimeve shëndetësore për të gjithë qytetarët e Kosovës. Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka bërë me dije se tanimë janë në prag të finalizimit të rishikimit të Ligjit për shëndetësi dhe atij për sigurime shëndetësore



shumë të mëdha qëkur ministri Ismaili ka marrë drejtimin e këtij sektori. Nuk kam parë asnjë ministër, i cili i ka kushtuar kaq shumë kohë projektit dhe ka qenë shumë i përfshirë në hollësitë e tij. Këtë rikonstruktivitet e shohim si trajektore shumë pozitive, prandaj Banka Botërore qëndron gati për t'ju mbështetur në çfarëdo mënyre që mundet. Sektori shëndetësor është çelësi për zhvillimin e Kosovës dhe do të jemi pranë jush", ka thënë Garido. Ndërkaq ministri i Financave, Bedri Hamza, ka thënë se Qeveria

e Kosovës e ka vendosur në prioritetet e veta edhe shëndetësinë dhe kjo ka ardhur si rezultat edhe i punës dhe angazhimeve maksimale të ministrit Ismaili. "Nëse bëjmë krahasime në mes të viteve, ka ndryshime të mëdha të gjendjes në shëndetësi. Prandaj, Ministria e Financave do të jetë afër për mbështetje të këtij sektori, të këtij projekti, i cili mund të jetë shembull i mirë i vënies së një bashkëpunimi edhe më të madh me Bankën Botërore", ka thënë ai. Koordinatorja e projektit, Fatime

Arenliu-Qosaj, ka theksuar se ishte me shumë rëndësi që Komiteti Drejtues, në kuadër të detyrave të veta, u zotua ta shtojë tutje dinamikën e implementimit të projektit, në mënyrë që të arrihen të gjitha rezultatet e parapara me këtë projekt pasi, sipas saj, e gjithë kjo punë në fund ka për qëllim përmirësimin e shërbimeve shëndetësore për të gjithë qytetarët e Kosovës. Projekti i Shëndetësisë së Kosovës është bërë efektiv në maj të vitit 2015 dhe pritet të përfundojë në tetor të vitit 2019.

EPOKA  
ERE **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 14 NËNTOR** - Nën udhëheqjen e ministrit të Shëndetësisë, Uran Ismaili, të mërkurën është mbajtur takimi i Komitetit Drejtues të Projektit për Shëndetësinë e Kosovës. Projekti i Shëndetësisë së Kosovës është projekt i Qeverisë së Kosovës, i financuar nga huamarrja e Bankës Botërore dhe synon përkrahjen e themelimit të shtyllave kryesore për themelimin e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore dhe forcimin e kujdesit parësor shëndetësor. Ministri Ismaili i ka njoftuar anëtarët e Komitetit për rikonstruktivitetin e projektit, i cili është bërë me qëllim të adaptimit të aktiviteteve, bazuar në kapacitetet absorbuese të Ministrisë së Shëndetësisë, gjegjësisht Fondit të Sigurimeve Shëndetësore. "Kemi bërë ç'është

e mundur që ta kemi projektin në nivelin që është sot. Sot projekti është pjesë përbërëse e planeve dhe aktiviteteve të strukturave përbërëse të Ministrisë dhe Fondit të Sigurimeve", ka thënë ministri Ismaili, duke shtuar se janë në proces të finalizimit të rishikimit të Ligjit për shëndetësi dhe Ligjit për sigurime shëndetësore që, sipas tij, do ta mundësojnë funksionalizimin e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, duke përfshirë këtu edhe skemën e barnave jashtë-spitalore. Pjesëmarrës në këtë takim në cilësinë e vëzhguesit ishte dhe përfaqësuesi i Bankës Botërore, Diego Garrido Martin, zyrtar i lartë i operacioneve/zëvendës-menaxher i Bankës Botërore në Kosovë. Ai ka thënë se mbajtja e këtij takimi është shenjë e qartë e trendit pozitiv në të cilin do të shkojë projekti, duke theksuar punën e madhe të ministrit Ismaili. "Kemi parë ndryshime

## Gjykata e Apelit konfirmon pafajësinë e Limajt në rastin 'Bellanica'

**PRISHTINË, 14 NËNTOR** - Gjykata e Apelit e ka vërtetuar gjykimin e Gjykatës Themelore të Gjakovës që e shpalli Fatmir Limajn të pafajshëm në rastin e njohur si 'Bellanica'. Gjykata Themelore në Gjakovë në mars të këtij viti ka shpallur të pafajshëm Fatmir Limajn në lidhje me vrasjet e dy civilëve Ramiz Hoxhës e Selman Binishi. Hoxha e Binishi ishin vrarë më 2 tetor 1998 në Komunën e Malishevës gjatë kohës së luftës pasi, sipas prokurorisë, ishin marrë nga persona të maskuar e të armatosur me uniforma të UÇK-së. Lidhur me këtë rast, aktakuza ndaj Limajt për krime lufte ishte ngritur më 28 tetor 2016. Në aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të siguruar nga "kallxo.com" u refuzua si e pabazë ankesa e Prokurorisë Speciale të Kosovës ndaj aktgjykimin të Gjykatës Themelore të Gjakovës. "Gjykata aktgjykimin e vlerësoi dhe gjeti se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të qarta dhe të plota rreth argumentit se i akuzuari Fatmir Limaj nuk është kryes i

veprës penale 'krimi i luftës kundër popullsisë civile... krimet e luftës për shkelje të rënda... të përbashkëta me konventat e Gjenevës...", thuhet në aktgjykim. Aktakuza ndaj Limajt për krime lufte ishte ngritur më 28 tetor 2016. Në aktgjykimin tutje thuhet "gjykata drejt ka vlerësuar se nuk është provuar me asnjë provë të vetme se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila ka qenë objekt i akuzës dhe nuk ekziston asnjë fakt vendimtar, apo provë e besueshme, se i akuzuari Fatmir Limaj, si pjesëtar i UÇK-së, ka qenë komandant ushtarak i Brigadës 121 e, sipas objektit të akuzës, Brigada 121 është formuar gjatë muajit gusht të vitit 1998 në të cilën dhomë të përgjegjësisë civile hyn edhe fshati Bellanicë. Më 2. 10. 1998 janë marrë të ndjerët Ramiz Hoxha nga Bellanica dhe Selman Binishi nga fshati Banjë nga persona të paignifikuar, në një veturë e markës "Golf", të cilët më vonë



janë gjetur të vdekur dhe të ekzekutuar në hyrjen e fshatit Kravaseri. Aktakuza e ngarkonte të pandehurin Fatmir Limaj se si pjesëtar i UÇK-së dhe komandant i Brigadës 121 nuk ka ndërmarrë masa të arsyeshme dhe të nevojshme brenda kompetencave të tij për ta parandaluar apo për ta ndaluar vrasjen e Ramiz

Hoxhës dhe Selman Binishit. Sipas Prokurorisë Speciale, Ramiz Hoxha nga fshati Bellanicë dhe Selman Binishi nga fshati Banjë, Komuna e Malishevës, më 2 tetor 1998 janë marrë në afërsi të xhamisë së fshatit Bellanicë dhe janë ekzekutuar në hyrje të fshatit Kravaseri.

Prokuroria në aktakuzë pretendonte se Fatmir Limaj i ka parë kufomat e viktimave dhe e ka ditur për krimin e kryer, mirëpo me vetëdije nuk ka ndërmarrë masa për zbulimin e kryesve të këtij krimi dhe rastin asnjëherë nuk e ka paraqitur tek organet kompetente për hetim dhe ndjekje.

# Haradinaj: Kosova ka krijuar infrastrukturë ligjore për t'i transferuar prodhimet në tregjet e huaja



**Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka marrë pjesë të mërkurën në hapjen e edicionit të dytë të Konventës së Veshmbathjeve të Kosovës. Me këtë rast, Haradinaj ka shprehur gatishmërinë e Qeverisë për t'i ndihmuar prodhuesit vendorë**

**EPOKA E RE** **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 14 NËNTOR** - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, mori pjesë në hapjen e edicionit të dytë të Konventës së Veshmbathjeve të Kosovës. Me këtë rast, ai ka shprehur gatishmërinë e Qeverisë së Kosovës për t'i ndihmuar prodhuesit vendorë. "Si Qeveri jemi të gatshëm të bashkëprojmojmë, që prodhimet tona të Kosovës, të arriturat e

prodhuesve tanë, pra të industrisë së veshmbathjes t'i plasojmë dhe jo vetëm kaq. Jemi të interesuar të sjellim investitorë për ju", kështu deklaroi Haradinaj. Ai ka thënë se me brendet e Kosovës që po paraqiten me dizajnet e krijuara nga studentët dhe që lidhen me veshmbathjet po krijojnë një qendërshëmëri ekonomike çdo ditë e më tepër.

Për këtë ngjarje kryeministri ka falënderuar Ambasadën e Amerikës, USAID-in, por edhe të

gjithë ata të cilët kanë shprehur një kujdes dhe përkrahje për t'i ndihmuar prodhuesit e veshmbathjes në Kosovë. "Eksporti i Kosovës, sipas Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë 2016-2018, është diku 20.5 milionë euro, ndërsa importi në periudhën e njëjtë kohore në produktet e njëjta është 228.6 milionë euro", ka theksuar ai, duke shtuar se vlera e një produkti të veshmbathjes kur e eksportojmë, vlera e tij është rreth katër euro, ndërsa e atij që e importojmë është 7.5 euro, që nënkupton gati dyfishin", ka deklaruar ai.

Pos të tjerash, kryeministri Haradinaj ka thënë se duke e parë që eksporti është më i vogël dhe çmimi i veshmbathjes në import është dyfish më i lartë, atëherë duhen përkrahur prodhuesit me

brendet e reja që po i paraqesin edhe me fondet që ia kemi alokuar në Ministrinë e Inovacionit.

Duke parë që kjo industri mund të jetë e rëndësishme dhe mund t'i japë rezultatet e veta, kryeministri Haradinaj ka deklaruar se duhet pasur kujdes edhe në shkollimin profesional që aftësitë krijuese të studentëve të lidhen me prodhuesit dhe të kenë cilësinë e duhur që të bëhen konkurruese në treg. "Kosova ka krijuar infrastrukturë ligjore për t'i transferuar prodhimet nga tregjet dhe nuk ka nevojë që partnerët të cilët do të kishin mundur që të investojnë me ju, të shkojnë shumë larg, por mund të investojnë në Kosovë", ka theksuar Haradinaj, duke shtuar se mundësitë janë afatgjata me krijimin e zonave ekonomike, ku

një ndër to është edhe Zona Ekonomike Amerikane.

Haradinaj ka sqaruar se ata të cilët investojnë në Kosovë taksën në dividendë e kanë zero; tatimi në fitim është 10 për qind, më i vogli në regjion; tatimi në paga nuk shkon mbi 10 për qind; është taksë zero me shtetet e EU-së; transporti është më i liri i mundshëm dhe, nga e gjithë kjo, është e sigurt se nga një produkt që prodhohet në Kosovë do të mund të dalë dhe hyjë në treg të BE-së 30 deri në 40 për qind më lirë se një produkt i prodhuar diku tjetër në Evropë.

Konventa e Veshmbathjeve të Kosovës organizohet çdo vit për t'i promovuar prodhuesit e veshmbathjeve të Kosovës dhe për ta mbështetur rritjen e industrisë së veshmbathjeve në Kosovë.

## Lansohet "Fondi i Inovacionit" financiar nga Ministria e Inovacionit dhe GIZ-i

**PRISHTINË, 14 NËNTOR (ER)** - Ministri i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, ka lansuar skemën e re të granteve të Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë "Fondi i Inovacionit", me mundësi përfitimi prej 50 000 eurosh. "Skema e granteve 'Fondi i Inovacionit' do t'i mbështesë NVM-të për zhvillimin e konceptit

të tyre të inovacionit duke prezantuar produkte, shërbime, procese të reja të përmirësuara, me qëllim të rritjes së potencialit të tyre ekonomik, në tregjet e brendshme dhe ndërkombëtare", ka theksuar ministri Beqaj me rastin e lansimit të Fondit të Inovacionit. Ministri Beqaj ka thënë se ky fond është një mundësi më shumë për ndërmarrësit, për më shumë

mjete të investuara drejtpërdrejt në sektorin privat nga Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë. "Fondi i Inovacionit" është bashkëfinansim i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë dhe GIZ-it përmes projektit "Krijimi i punësimit përmes promovimit të eksportit" (CETEP) dhe implementohet nga Qendra e Inovacionit e Kosovës (ICK).



Projekti parashihet të ketë ndikim në katër fusha të veprimtimit sipas

nevojave të sektorit privat në sektorët: bujqësia, TIK-u dhe prodhimi. Fushat në të cilat do të mbështeten NVM-të janë: informacioni i lidhur me biznesin, shërbimet e biznesit të orientuara drejt tregut, inovacionet e produktit dhe procesit dhe promovimi i eksporteve. Data e fundit për aplikim për grante të këtij fondi është 30 nëntor, në orën 16:00.



## S'ka vullnet politik për ndërmarrjen 'Trepça'

Në mungesë të kuorumit ka dështuar të mërkurën mbledhja e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, në të cilën ishin të ftuar të raportojnë për gjendjen e "Trepçë"-s ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, dhe përfaqësuesit e bordit të kësaj ndërmarrje. Pos mungesës së disa anëtarëve të komisionit nuk ishte i pranishëm as ministri Lluka. Ndërsa kryesuesit të bordit të "Trepçë"-s, Ardian Sylës, i është pamundësuar raportimi, edhe pse ishte i pranishëm



Berisha-Shala ka thënë se është për keqardhje mungesa e deputetëve dhe mungesa e vullnetit politik sa i përket funksionalizimit të ndërmarrjes "Trepça". "Është për keqardhje mungesa e deputetëve në

komision dhe mungesa e vullnetit politik. Ne po shohim se në çfarë gjendje është 'Trepça', prandaj duhet të jemi më vigjilentë në këtë drejtim", ka deklaruar ajo. Të pranishëm në këtë mbledhje

ishin Sala Berisha-Shala, Hymete Bajrami, Liburn Aliu, Memli Krasniqi dhe Adem Hodza. Ndërkaq munguan Dardan Sejdiu, Lutfi Zharku dhe Duda Balje, Muharrem Nitaj dhe Veton Berisha.

**EPOKA ERE****A. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 14 NËNTOR** - Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, dhe përfaqësuesit e bordit të "Trepça" sh. A., të mërkurën ishin të ftuar që të raportojnë për gjendjen e "Trepçë"-s para anëtarëve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal. Kjo mbledhje ka dështuar për shkak të mungesës së kuorumit

të anëtarëve të komisionit, gjithashtu edhe të mospranisë të ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka.

Pas gjysmë ore pritje dhe mungesës së kuorumit, kryesuesja e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, Sala Berisha-Shala, e ka përmbyllur takimin. Mirëpo, edhe pse ishte i pranishëm kryesuesi i bordit të "Trepçë"-s, Ardian Sylës, këtij i është pamundësuar raportimi.

## Alarmohet për vigjilencë në hulumtimin e aksidenteve të lehta në komunikacion

**EPOKA ERE****A. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 14 NËNTOR** - Rritja enorme e aksidenteve të komunikacionit me dëme të vogla materiale, por me lëndime të rënda trupore, po konsiderohet shqetësim i madh për Industrinë e Sigurimeve, por edhe për qytetarët që i kanë shkaktuar ato, pasi një numër i madh i tyre duhet të përballen me institucionet e drejtësisë. Kështu u tha të mërkurën në tryezën e organizuar nga Shoqata e Sigurimeve e Kosovës në Prishtinë, ku ishin të pranishëm edhe përfaqësuesit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, zyrtarë të Policisë së Kosovës, përfaqësuesit të Bankës Qendrore të Kosovës, drejtori i Klinikës Emergjente në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës,

drejtori i Mjekësisë Ligjore, por edhe drejtues dhe përfaqësues të kompanive të sigurimeve që operojnë në vendin tonë.

Në hapjen e takimit drejtori i Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës, Sami Mazreku, ka thënë se, bazuar në të dhënat që kanë nga kompanitë e sigurimeve veç e veç, por edhe në të dhënat publike të Policisë së Kosovës, shihet se në vazhdimësi ka rritje të aksidenteve me dëmtime minimale materiale. "Ta zëmë, ne kemi pasur raste kur dëmi në makinë nga aksidenti është 100 euro, kurse dëmi shëndetësor mbi 5 000 euro apo edhe më shumë euro. Shpeshherë nuk përputhet diagnoza apo edhe incizimet me të dhënat e personit në fjalë. Nuk janë të vogla rastet kur qytetarët sjellin nëpër kompani incizime të vjetra të person-

ave të tjerë, madje ato as nga afër nuk përkojnë me diagnozën e qytetarit i cili aplikon për rimbursim në kompani të sigurimit. Fatkeqësisht, janë në rritje kërkesat e qytetarëve që aplikojnë për rimbursim me diagnozë të njëjtë e që, fatkeqësisht, disa prej tyre është e vështirë të verifikohen pastaj nga ne", ka thënë Mazreku.

Drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore, Arsim Gërxhaliu, ka deklaruar se gjykatat nuk po i sjellin të gjitha rastet e aksidenteve për autopsi. Sipas tij, kjo është tejet shqetësuese dhe gjithmonë gjykatat arsyetohen se familja nuk dëshiron të bëjë autopsi. Ai foli edhe për sigurinë në komunikacion. Sipas tij, mbi 90 për qind të rasteve të vdekjeve në komunikacion janë si pasojë e mosvendosjes së rripit të sigurisë.

### REKOMANDIMET PAS TRYEZËS:

1. Krijimi i databazës elektronike të përbashkët QKUK, PK, Sigurime, Prokurori.
2. Kujdesi i shtuar në dokumentacion mjekësor nga QKUK e QKMF, brenda 24 orëve.
3. Ripërtëritja e listës së ekspertëve gjyqësorë që japin mendime/vlerësime mbi lëndimet në aksident: Përcaktimi i kushteve dhe kriterëve për licencim.
4. Rishikimi i kriterëve - tabelave mjekësore mbi lëndimet e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë.
5. Kampanjat e përbashkëta vetëdijësuese për përgjegjësitë, organizuar në bashkëpunim: ShSK, QKUK, QKMF, PK, KPK, KGJK, MPB.

Edhe Basri Lenjani, drejtori i Emergjencës në Qendrën Klinike Emergjente të Kosovës, nuk e ka përjashtuar mundësitë e keqpërdorimeve. Ai ka ftuar të pranishmit që të flasin konkretisht me emra në rastet kur dyshohet se diagnoza që ia ka shënuar mjeku nuk përputhet me

gjendjen reale të personit që ka qenë pjesë e aksidentit. Po ashtu, gjatë prezantimit edhe Samedin Mehmeti nga Policia e Kosovës ka folur për procedurat e policisë në rastet e aksidenteve. Për procedurën ka folur edhe Sebahate Muharremi nga Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës.

## Gjilani do të bëhet me matës digjital të ujit

**GJILAN, 14 NËNTOR (ER)** - Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, dhe ai i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, kanë konfirmuar mbështetjen për projektet e mëdha për Gjilani që janë duke u zhvilluar në këtë vit dhe në vitin 2019. Kryetari i komunës, Lutfi Haziri, ka falënderuar ministri Matoshi dhe Lluka për vizitën dhe zotimin e përkrahjes për Gjilani. Haziri ka treguar se programet më të mëdha që ka qeverisja lokale në Gjilan janë përfundimi i shtratit të lumit "Mirusha", sanimi i kapërderdhës në Përlepnicë dhe eficienta e energjisë në tri shkolla. "Ndërkaq me Ministrinë e Mjedisit ne po planifikojmë edhe për ndërtimin e tri parqeve, pastaj

rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimeve", ka thënë Haziri.

Në takimin e përbashkët ministri Lluka ka njoftuar udhëheqësin e Komunës së Gjilanit se një prej projekteve të ardhshëm është ndryshimi i matësve të vjetër në ata digjitalë dhe ndërtimi i gypave nga azbesti. "Në Kosovë 58 për qind e ujërave të prodhuar humbin për shkak të vjetërsisë së mjeteve, matjeve të gabuara dhe kycjeve ilegale. Në këtë qeverisje ujërat kanë marrë një fokus të veçantë dhe do të luftohen problemet në këtë sektor. Në takim me kryetarin Haziri kemi biseduar për ndryshimin e matësve të vjetër në ata digjitalë si dhe ndërtimin e gypave nga azbesti", ka thënë Lluka.



## Në Rahovec fillojnë gjobat mandatore për ata që hedhin mbeturina

**RAHOVEC, 14 NËNTOR (ER)** - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, i shoqëruar nga drejtori i Drejtorisë për Punë Inspektuese, Besnik Hoti, inspektorët e kësaj drejtorie si dhe drejtori i DUPMM-së, Rumir Zhunqi, kanë vizituar fshatin Polluzhë dhe nga aty

kanë njoftuar se nga sot (e enjte) do të fillohet me gjoba mandatore për ata që hedhin mbeturina në vende joadekuate. "Veprimeve të tilla skandaloze duhet t'u themi mjaft. Hedhja e mbeturinave në natyrë, për më tepër, tek një lokacion i shenjtë siç është varri i dëshmorit Afrim Bajraktari në Polluzhë, është akt

i ulët që s'bën të ndodhë. Nga dita e enjte do të fillojnë gjobat mandatore për ata që hedhin mbeturina në vende joadekuate dhe ne si komunë jemi të përkushtuar t'i shkojmë deri në fund kësaj pune. Ta mbajmë bashkë Rahovecin tonë të pastër e të bukur", është shprehur kryetari Latifi.



## Haskuka: Siguria e qytetarëve, prioritet i institucioneve relevante

**PRIZREN, 14 NËNTOR (ER)** - Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi i Komunës së Prizrenit ka mbajtur mbledhjen e radhës e cila është drejtuar nga kryetari i komunës, Mytaher Haskuka. Pas miratimit të procesverbalëve nga mbledhjet e kaluara dhe miratimit të rendit të ditës u prezantuan planet dhe projektet e realizuara të Policisë së Kosovës për situatën e sigurisë për periudhën gusht-tetor 2018, me ç'rast pati diskutim për çështje të ndryshme si parkingjet ilegale, siguria në shkolla, planet operative rreth rasteve të grabitjes, aksionet ndaj lëmshëkërkuesve, trajtimi ndaj qenve endacakë, tollovia e krijuar në Lubizhdë nga

tregu i automjeteve, orari i punës së lokaleve hoteliere dhe zhurma e krijuar nga to etj. Më pas nga Drejtoria e Arsimit u prezantuan projektet dhe sfidat e kësaj drejtorie për sigurinë në institucionet shkollore në Komunën e Prizrenit për periudhën shtator-tetor 2018. Këtu vëmendje e veçantë iu kushtua nevojës për angazhimin e pedagogëve dhe psikologëve në shkolla, projekt ky që do të fillojë të realizohet nga viti i ardhshëm. Një çështje tjetër e cila u parashtrua në mbledhje ishte edhe ajo për funksionalizimin e kamerave të sigurisë. Në lidhje me këtë u sqarua se Drejtoria për

Emergjencë dhe Siguri nga fillimi i vitit të ardhshëm do të fillojë t'i rregullojë dhe t'i funksionalizojë kamerat ekzistuese, njëkohësisht edhe do ta shtojë numrin e kamerave, ndërsa u pajtua që lokacionet e kamerave të reja të caktohen në pika strategjike, në koordinim me Policinë e Kosovës. Në fund pjesëmarrësit në mbledhje u pajtuan për caktimin e grupeve punuese në koordinim me Organizatat e Sigurisë për mbajtjen e dy takimeve me qytetarë, për sigurinë publike në Komunën e Prizrenit, ndërsa anëtarët e grupeve punuese do të propozohen ndërkohë nga organizatat përkatëse.

## Bëhet shenjëzimi i rrugëve kryesore të Malishevës

**MALISHEVË, 14 NËNTOR (ER)** - Në kuadër të mirëmbajtjes së rrugëve në territorin e Komunës së Malishevës ka filluar të bëhet shenjëzimi në rrugë apo vendosja e sinjalistikës në rrugët kryesore në qytet dhe në rrugët ku qarkullimi i veturave është më i madh, përkatësisht në rrugët regionale. Shenjëzimi në rrugë bëhet me qëllim të krijimit të sigurisë për këmbësorët. Sipas drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike në Komunën e Malishevës,

Milazim Morina, në projektin e shenjëzimit të rrugëve janë përfshirë të gjitha rrugët kryesore në qytetin e Malishevës, si dhe katër rrugët kryesore, apo rrugët regionale, ku rëndësi e veçantë u është kushtuar shkollave në të cilat janë duke u vendosur shenjat në afërsi të objekteve shkollore. Projekti i shenjëzimit të rrugëve, apo vendosja e sinjalistikës në rrugë, kap një shumë prej 17 eurove dhe financohet nga buxheti i Komunës së Malishevës.





## Sekretari Mattis viziton kufirin me Meksikën

WASHINGTON, 14 NËNTOR - Sekretari amerikan i Mbrojtjes Jim Mattis ka shkuar të martën në kufirin me Meksikën ku do të inspektojë një pjesë të mijëra trupave që janë mobilizuar për të ndihmuar në operacionet e sigurisë në kufi.

Një pjesë e mirë e mijëra trupave të vendosura në kufi janë duke ndërtuar kazerma prej tendash, ose si këta ushtarë,

duke vendosur barriera me tela gjemborë.

Xhenieri Jordan Wilson, shtrin telat nga ura ndërkombëtare në portën hyrëse Brownsville. Ai habitet edhe vetë që e kanë dislokuar këtu dhe jo jashtë Amerikës, siç ndodh zakonisht.

"Ishte një habi për mua. Ndodhi shumë shpejt, por është një mision me rëndësi. Puna ime është të shtrij telat me gjemba

për të siguruar mbështetje", tha ai.

Shumica e trupave, si këto, janë vendosur në Teksas. Të tjerët, në Kaliforni dhe Arizona.

Një karvan prej disa mijëra emigrantësh nga Amerika Qendrore që udhëton nëpër Meksikë drejt ShBA-së, bëri që presidenti Trump të nxirrte urdhrin për dërgimin e trupave, dhe kjo u bë shkak për polemika.



## Britania dhe vështirësisë për daljen nga BE-ja

Projekt marrëveshja për daljen e Britanisë nga BE-ja prej 500 faqesh mbetet një burim mosmarrëveshjesh të thella brenda Partisë Konservatore dhe në parlamentin e vendit, i cili do të ketë fjalën përfundimtare nëse do ta miratojë atë

LONDËR, 14 NËNTOR - Kryeministria britanike Theresa May u përpoq të mërkurën të bindë kabinetin e saj për një projekt marrëveshje për daljen e Britanisë nga BE-ja, pasi negociatorët britanikë e përfunduan pas shumë muajsh bisedimesh të lodhshme me homologët e tyre të Bashkimit Evropian.

Por projekti prej 500 faqesh mbetet një burim mosmarrëveshjesh të thella brenda partisë konservatore dhe gjithashtu në parlamentin e vendit, i cili do të ketë fjalën përfundimtare nëse do ta miratojë atë. Ndërsa lajmi doli të martën se për një variant u ra dakord, përkrahësit e vijës së ashpër të daljes nga BE-ja rreshtuan për të sulmuar marrëveshjen e propozuar me ish-ministrin e Jashtëm britanik Boris Johnson, i cili dha dorëheqjen më parë këtë vit, duke u kërkuar ministrave të tjerë të bashkohen me të në kundërshtim me kushtet e marrëveshjes. Partitë kryesore të opozitës britanike gjithashtu njoftuan mospranimin e marrëveshjes, e cila ende nuk është publikuar. Marrëveshja, nëse miratohet nga kabineti dhe më pas nga Parlamenti britanik, do të parashikonte që Britania të mbetet në një bashkim doganor për disa vjet me BE-në pasi të dalë zyrtarisht nga blloku në mars, por me një rrugë të paqartë ligjore për të hequr dorë nga marrëveshja doganore, ndërkohë që marrëveshja më e plotë tregtare është duke u negociuar.

Mbetja në një bashkim doganor lejon Britaninë dhe BE-në të shmangin futjen e kontrolleve doganore përgjatë kufirit që ndan Irlandën e Veriut dhe Republikën e Irlandës dhe gjithashtu do të lejonte "tregti pa frikë" midis Britanisë dhe partnerëve të saj të mëparshëm në BE-së.

Por kritikët thonë se kjo do ta kthejë Britaninë në statusin e një "shteti vasal" duke kërkuar që ajo të pranojë pakushte rregullat dhe rregulloret e BE-së. Kjo gjithashtu do të bllokonte Britaninë nga nënshkrimi i marrëveshjeve tregtare me vendet e tjera, ndërkohë që një marrëveshje tregtare përfundoi me BE-në, e cila vetë mund të zgjasë tri apo katër vjet ose edhe më gjatë. Arritja e marrëveshjeve të tregtisë në mënyrë të pavarur me vendet jo anëtare të BE-së ishte një pikë kryesore për t'i bindur shumë britanikët për të votuar për daljen nga BE-ja gati dy vjet më parë në një referendum për të hequr dorë nga anëtarësimi në BE. "Nuk ka ku të shkojë më keq", tha Boris Xhonsion të martën për gazetarët në korridoret e Dhomës Britanike të Komunave. Përkrahës të tjerë u bashkuan me të për të denoncuar marrëveshjen e propozuar, të cilën ata janë të vendosur për ta sabotuar që të mos miratohet, thonë ata.

"Për herë të parë në një mijë vjet në këtë vend, ky parlament nuk do të ketë fuqi mbi ligjet që qeverisin këtë vend. Është një gjendje mjaft e pabesueshme", shtoi



Boris Johnson. "Kryeministria ka arritur një marrëveshje jo vetëm dorëzimi në Bruksel, por edhe më keq, Britania do të jetë një shtet skllav", tha ligjvënësi konservator Jacob Rees-Mogg. Drafti i marrëveshjes, fati i kryeministres në këtë post si dhe jetëgjatësia e qeverisë konservatore janë të gjitha në peshore. Pasojat e procesit për të marrë miratimin e projekt marrëveshjes janë të vështira për t'u menduar dhe mund të sjellë fundin e kryeministres, të qeverisë konservatore dhe madje vetë Brexit. "Askush nuk e di se ç'do të ndodhë", thotë ligjvënësi laburist Chuka Umunna. Qeveria e pakicës e May në Dhomën e Përfaqësuesve mbështetet në votat e një grusht ligjvënësish nga një parti e Unionistëve protestante, e cila gjithashtu është kundër propozimit. Pa mbështetjen e partisë Bashkimi Demokrat dhe ndërsa përballet me një kundër-

shim të pashmangshëm nga dhjetor, ligjvënës konservator, kryeministria May do të duhet t'i bindë ligjvënësit e opozitës që të votojnë përtej vijave partiake duke argumentuar se marrëveshja e saj është më e mira që Britania mund të marrë. Votimi i dytë? Por një numër gjithnjë e më i madh ligjvënësish të opozitës janë duke u bashkuar me lëvizjen e votës popullore, e cila po bën thirrje për një referendum të dytë të Brexit. Sondazhet e fundit të opinionit sugjerojnë se shumica e votuesve tani, sidomos në zona laburiste, shumë prej të cilëve kanë votuar në qershor 2016 për Brexit, tani duan që Britania të mbajë anëtarësimin në BE, duke u frikësuar nga pasojat ekonomike. Por edhe para se të kërkojnë mbështetjen e parlamentit muajin e ardhshëm për projektin e bashkimit doganor, Thereza May duhet të bindë kabinetin e saj për ta mbështetur

atë - dhe kjo nuk është gjë e sigurt. Të martën - përpara një takimi të plotë të kabinetit të thirrur për të mërkurën pasdite, May ndoqi shembullin e paraardhëses së saj konservatore Margaret Thatcher, e cila në vitin 1990 i thirri ministrat një nga një për t'i bërë të përgjegjshëm dhe për të kërkuar mbështetjen e tyre. Por taktikë nuk dha rezultat dhe Thatcher u detyrua të jepte dorëheqjen. Ish-udhëheqësi konservator Iain Duncan Smith parashikoi se ditët e kryeministres May do të jenë të numëruara nëse nuk arrin të ndryshojë rrugën dhe të vendosë të mos ndjekë një ndarje të plotë nga BE-ja. Nëse kabineti pajtohet, partia me siguri jo", thotë ai. Ligjvënësit konservatorë që duan që Britania të mbetet në BE gjithashtu po e kundërshtojnë publikisht projekt-marrëveshjen, duke e vendosur kryeministren në pozitë të ngushtë politike.

## Rusia thotë se ShBA-ja po shkakton shqetësim të thellë global

MOSKË, 14 NËNTOR - Kremli tha të mërkurën se Shtetet e Bashkuara po shkaktojnë "shqetësim të thellë global". Zëdhënësi Dmitry Peskov i bëri këto komente dy javë përpara një takimi të pritur midis presidentit rus,

Vladimir Putin, dhe atij amerikan, Donald Trump, në Argentinë.

"Fakti se Amerika është bërë e paparashikueshme së voni, nuk është sekret për askënd", tha Peskov.

"Një paparashikueshmëri e

tillë nga vendi më i madh, ekonomia më e fuqishme në botë, është shqetësim i thellë global", tha ai.

Peskov nuk e kritikoi në mënyrë specifike Trumpin. Zyrtarët rusë vazhdimisht thonë se Trumpi do marrëd-

hënie më të mira me Rusinë, porse atë e pengojnë kundërshtarët "rusofobikë" në ShBA. ShBA-ja dhe aleatët e saj perëndimorë e kanë sanksionuar Rusinë për aneksimin e gadishullit ukrainas të Krimesë në vitin 2014.



Me rastin e 110-vjetorit të krijimit të alfabetit të gjuhës shqipe. Një përvjetor i ndritur (2)

# GJUHA DHE ASIMILIMI NACIONAL

Gjergj Fishta shkroi: "Alfabeti i vetmi mjet me të cilin kombi do të përparojë. Po të mos zgjidhej alfabeti, Shqipëria do të pësojë humbje të mëdha, madje është e parëndësishme se cili do të jetë ai, por ta kemi një"



Hasan MUJAJ

Gjurmimet sociolinguistike në vende të ndryshme kanë dëshmuar se mospërdorimi i gjuhës amtare nga familja dhe deri në nivelin më të lartë të përdorimit publik të gjuhës, sidomos në rrethanat e jetës shumëgjuhësore, ka sjellë shkallë-shkallë asimilimin nacional dhe humbjen e identitetit kombëtar. Kjo tendencë ishte shtrirë edhe në realitetin shqiptar të asaj kohe, mirëpo nuk u sendërtua pasi ndeshi në veprimtarinë e gjerë të lëvizjes kombëtare dhe të përcaktimit të saj për t'i ruajtur dhe për t'i kultivuar më tej vlerat e larta të identitetit kombëtar.

E dhëna se në Kongresin e Manastirit nuk morën pjesë vetëm studiues të gjuhës e të letërsisë, porse edhe shumë veprimtarë të përcaktuar denjësisht për zgjidhjen e çështjes shqiptare, dëshmon se krijimi i një alfabeti për gjuhën shqipe ishte shtruar në nivelin kombëtar dhe jo vetëm në elitën kulturore, por edhe në të gjitha shtresat shoqërore si çështje shumë e rëndësishme për kombin, e cila kërkonte zgjidhje të shpejtë.

Kongresi i Manastirit bëri jehonë të madhe edhe në qarqet ndërkombëtare. Ai tronditi në veçanti qeveritë e vendeve që asokohe zhvillonin politikë anti-shqiptare: Bullgaria, Serbia etj. (Aty, f. 35), të cilat, përmes publikimeve të ndryshme, përpëshin ta pengonin dhe ta çoragonizonin lëvizjen kulturore e arsimore të shqiptarëve për shtet të pavarur.

Sikundër dihet nga të dhënat e shkruara, në Kongresin e Manastirit qenë të pranishëm edhe shumë pjesëmarrës që nuk ishin delegatë të autorizuar shoqërisht e klubesh shqiptare, porse në kongres merrnin pjesë nga kërshëria e madhe për t'i dhënë atij mbështetje morale e kombëtare. Kjo prani u pa, sido-

mos dy ditët e para të Kongresit (më 14 e 15 nëntor) në të cilat u zhvilluan shumë diskutime që karakterizoheshin nga një porosi e madhe: bashkimi i shqiptarëve pa dallime rajonesh e fesh dhe veprimtaria e vazhdueshme dhe e thukët për zhvillimin arsimor, kulturor dhe ekonomik të Shqipërisë. Sipas oratorëve alfabeti ishte parakusht i këtij zhvillimi.

Alfabetet e shoqërive të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, që përdoreshin për shkrimin e shqipes, e pengonin harmonizimin e përpjekjeve që bëheshin për të krijuar një alfabet të përbashkët të shqipes. Madje krijoheshin edhe ndasi e grupe rivalitetesh mbi baza të përkatësive rajonale ndonëse në thelb klubet e shoqëritë kulturore kishin një qëllim: një alfabet të gjuhës shqipe.

Bëhet e ditur se në verën e vitit 1908, si pararendje e ngritjes së moralit dhe edukimit kombëtar, në qytete e fshatra krahinash të ndryshme shqiptare, u themeluan klube të reja kulturore shqiptare, të cilat u bënë qendra të zhvillimit të arsimit shqip dhe të krijimit të një alfabeti të gjuhës shqipe. Klubet shërbenin edhe si shkolla të mësimit e të shkrimit të gjuhës shqipe.

Kështu veproi në vjeshtën e vitit

1908 edhe klubi i Shkupit në krye me Nexhip Dragën. Autoritetet xhonturke, për ta penguar mësimin dhe shkrimin e shqipes, në Durrës, Shkodër, Dibër etj. i angazhuan edhe klerikët myslimanë kinse kjo veprimtari ishte "kundër" fesë islame dhe Kuranit! Shtypi shqiptar bëri propagandë të vazhdueshme për rëndësinë e hapjes së shkollave shqipe si dhe për domethënien e madhe që kishte krijimi i alfabetit të gjuhës shqipe.

Edhe Gjergj Fishta, çështjen e një alfabeti unik të gjuhës shqipe, në fjalimin e tij në Kongresin e Manastirit, e trajtoi si domosdoshmëri për qytetërimin shqiptar, d. m. th. e vuri re atë si bazament sociologjik e sociolinguistik, e trajtoi atë si pikënisje themelore të zhvillimit dhe të unitetit gjithëkombëtar.

Ndonëse Kongresi i Manastirit, për arsye të disa reagimeve të porositura nga politika anti-shqiptare, duke miratuar dy alfabetet, la hapësirë që të vazhdonte propaganda e turqve të rinj për të favorizuar përdorimin e alfabetit arab duke krijuar kështu edhe më tej përçarje ndërshqiptare, ndërhyrja e elitës së lëvizjes kombëtare në krye me Hasan Prishtinën e të tjerë, bëri që të tejkalohesh gjendja e ndërlikuar dhe të mbizotërojë mendimi i përdorimit të alfabetit latin. Hasan Prishtina, Nexhip Draga etj. dolën në mbrojtjen e alfabetit latin dhe kundërshtuan propagandën xhonturke, bullgare, serbe e të qarqeve të tjera që kundërshtonin pavarësinë e

shtetit shqiptar. Ata diskredituan e kritikuan propagandën që mbështeste alfabetin arabo-osman për gjuhën shqipe. Politika e shteteve të sipërpërmendura, për të shtrirë ndikimin e përdorimit të alfabetit arab, themeloi në Shkup një vatër propagandistike të quajtur "Shoqëria për shkruarjen e gjuhës shqipe me alfabet arab" dhe organizoheshin e mbaheshin mitingje e forma të tjera reagimesh sipas të cilave kërkoheshin mënjanimi i alfabetit latin. Mbi këtë bazë u krijua edhe një përçarje e madhe brendashqiptare madje përdoreshin termat "latinistë", "arabistë" etj. Megjithatë, Kongresi shënoi kthesë të madhe historike për bashkimin dhe zhvillimin e përgjithshëm gjithëkombëtar. Aspekti sociolinguistik dhe sociologjik i Kongresit të Manastirit mund të vihet re edhe nga referimet e paraqitura në Kongres pas vendimit të alfabetit.

Kështu dom Nikollë Kaçorri, delegat nga Durrësi, referoi për temën: "Detyra e çdo shqiptari është të ndihmojë materialisht për përparimin e kombit të vet" (Aty, f. 83).

Edhe diskutues të tjerë, pasi konstatuan se miratimi i alfabetit do të sjellë zhvillimin arsimor, kulturor dhe shkencor, shtruan mbëhinë e konsolidimit dhe të bashkërendimit të të gjitha klubeve e shoqërive kulturore për kthesa zhvillimi, sidomos në pikëpamjen ekonomike dhe sociale të vendit.

Pas çështjes së alfabetit, Kongresi i Manastirit hartoi edhe një pro-

gram të veprimtarisë së mëtejme të lëvizjes kombëtare në të cilin përfshiheshin kërkesa me interes për zhvillimin kombëtar p. sh. shtrirja në terren të gjerë e arsimit në gjuhën shqipe, krijimi i ushtrisë kombëtare shqiptare me oficerët shqiptarë, hapja e një universiteti në gjuhën shqipe, zhvillimi ekonomik i vendit, shfrytëzimi i minierave, ndërtimi i hekurudhave, i rrugëve, i urave, zhvillimi i bujqësisë etj. (Muhamet Piraku, gazeta Zëri, 18. 10. 2008, f. 33). Sikundër shihet, me gjithë përpjekjet e xhonturqve për ta kufizuar punën e Kongresit të Manastirit vetëm rreth çështjes së alfabetit dhe pa hyrë në problemet politike dhe ekonomike, kjo nuk u arrit dot.

Gjergj Fishta do të shkruajë: "Alfabeti i vetmi mjet me të cilin kombi do të përparojë. Po të mos zgjidhej alfabeti, Shqipëria do të pësojë humbje të mëdha madje është e parëndësishme se cili do të jetë ai, por ta kemi një. Nga kjo varet bashkimi, përparimi dhe qytetërimi i kombit". (Kongresi i Manastirit, f. 106).

Kryetari i Klubit "Bashkimi", Fehim Zavalani, Kongresin e quajti Kongres të "bashkimit të të mundësujve të vejë përpara në qytetëri".

Nga konstatimet e mësipërme del e kuptueshme se Kongresi i Manastirit nuk u kufizua vetëm brenda problematikës së krijimit të alfabetit të gjuhës shqipe, porse ai mori në trajtim edhe shumë çështje të tjera me interes të veçantë për zhvillimin sociokulturor, ekonomik e politik të nivelit gjithëkombëtar. Andaj, rëndësia e këtij Kongresi duhet të ndiqet edhe në dritën e shkencave të integruara për t'i parë edhe aspektet sociale e politike që kishin të bënin me lëvizjen kombëtare shqiptare të kohës.

Pas Kongresit politika e turqve të rinj u përpoq t'ua detyronte shqiptarëve alfabetin arab, por ajo që politikë e dështuar. Dysia e alfabetëve u tejkalua gradualisht rreth një dekadë më pas: alfabeti i Stambollit, duke qenë më pak praktik, u mënjana dhe mbeti në përdorim alfabeti i shoqërisë "Bashkimi" të Shkodrës, alfabeti i shqipes së sotme. Shqipëria tani - u tha në fund të Kongresit - është e lumtur, "është e bashkuar me anën e alfabetit".

Klubi "Bashkimi" i Manastirit mori shumë mirënjohje të veçanta për organizimin e Kongresit të Manastirit dhe u shpall klubi qendror e drejtues për të gjitha klubet e tjera shqiptare. (Fund)



**E rrallë**

## Vajza gjen një kilogram kokainë në rrugë dhe nis ta shesë

Gjeti rastësisht një kilogram kokainë dhe papritmas bëhet tregtare droge. Clare Tague, 32-vjeçare nga Mançester, fshehu më shumë se një kilogram kokainë, me vlerë 276 mijë euro në dhomën e saj të gjumit, pasi e kishte gjetur në rrugë gjatë një shëtitjeje. Në



vështirësitë financiare për disa borxhe të lojërave të fatit, ajo vendosi ta shesë drogën, duke e fshehur atë brenda vezëve të çokolatës.

**FOTO E DITES**



Një kope zogjsh shihen afër një vinçi në Milano të Italisë. /AP/

**E jashtëzakonshme**

## I kalon makina përsipër derisa flinte në rrugë

Një i dehur, që e kishte zënë gjumi në rrugë, ka shpëtuar për mrekulli pasi u mor zvarrë nga një makinë. I dehuri me fat po shkonte në shtëpi gjatë natës, kur u shtri në mes të një rruge në Kinë. Një makinë që po kalonte me shpejtësi nuk e vuri re dhe e shtypi duke e çuar disa metra larg. Kur e kuptoi çfarë ndodhi,



shoferi ndaloi makinën dhe telefonoi policinë. Por, i mbijetoi aksidentit vetëm me disa gërvishtje.

**BARSOLETA E DITËS**



- Zonjë, jua sollëm burrin në shtëpi. Ishte aq i pitë sa, sa herë që e ngrehnim në këmbë, ai sërish binte përtokë.  
- Idiotë, po karrocën ku ia keni lënë?!




**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

**“ALPHA” 3D,**

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson  
Regjia: Albert Hughes

Vetem gjate vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

**“JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN”**

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.  
Regjia: David Kerr



Në ora 18:00

**“NIGHT SCHOOL”**

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.  
Regjia: Malcolm D. Lee



Në ora 20:00

**“SIBERIA”,**

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.  
Regjia: Matthew Ross



Në ora 22:00

**“VENOM” 3D,**

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.  
Regjia: Ruben Fleischer  
Based on the Marvel Comics



**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

 <p><b>DASHI</b> Doni pak qetësi sot dhe nëse nuk mund ta shijoni ditën siç ëndërroni, të paktën bëni të mundur që të mos keni debate dhe keqkuptime.</p>	 <p><b>DEMI</b> Nëse merreni kaq shumë kohë me punën nuk do të mund t'i dedikoni kohë jetës personale. Duhet t'i ndani prioritetet tuaja të momentit.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Edhe pse nuk keni marrë gjithçka që keni pretenduar, sot bëni mirë të lini pak kohë të kalojë përpara se të kërkonti shpjegime.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Keni pak vështirësi ta menaxhoni kohën për impenjimet tuaja sot. Nëse nuk ia arrini dot i vetëm, kërkonti ndihmë nga kolegët.</p>	 <p><b>LUANI</b> Nuk është se ju kanë mbetur shumë gjëra për t'i vlerësuar kohët e fundit. Të gjitha situatat që mund t'i shfrytëzoni i keni mbaruar.</p>	 <p><b>VIRGJËRËSHA</b> Disa kritika konstruktive është mirë kur bëhen në kohë sepse mund t'i rikuperoni. E rëndësishme është të mos i keqinterpretoni.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Keni hapur mundësi të reja bashkëpunimi me persona që i njihni mirë. Nuk jeni penduar aspak për shanset e reja që ju keni dhënë.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Edhe pse biseda me një mik të vjetër ju bën të mendoni qartë për situatat tuaja, sot nuk do të keni mundësi të konsumoni kohë me të.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Dikush do të jetë pjesë e projekteve dhe planeve tuaja në të ardhmen. Nuk keni pse e ndaloni sepse dhe ju mund t'ju japë shumë komoditet kjo gjë.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Sot nuk keni pse vihëni në garë me të tjerët për t'i treguar aftësitë tuaja. Nëse jeni i bindur që dini t'i bëni mirë gjërat nuk ka pse tregoni dyshime.</p>	 <p><b>UJORI</b> Nëse doni ta ngjyrosni ditën tuaj me sa më shumë humor atëherë duhet të bëni diçka si për ju dhe për personat që doni.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Sot do të keni bashkëpunime të frytshme në fushën profesionale dhe mund të vijoni të mbështeteni te të njëjtët persona.</p>


## Princi Charles feston 70-vjetorin e lindjes, fotografi e një gjyshi të lumtur



**N**jë fotografi e gëzuar familjare për Royal Family. Për herë të parë princi Charles shfaqet me të gjithë dinastinë e tij, i lumtur dhe i qeshur. Fotografia e realizuar në kopshtet e Clarence House për 70-vjetorin e ditëlindjes së princit të Galles, Charles shihet ulur pranë Dukeshës së Cornovaglias. Aty shihen edhe nipi

George, mbesa Charlotte, princi Louis dhe në barkun e Meghanit edhe nipi i katërt që pritet të vijë në pranverë. Mbrapa shpinës së Charlesit janë djemtë William dhe Harry dhe bashkëshortet Kate Middleton dhe Meghan Markle. Fotografia e gjyshit Charles është postuar edhe në rrjetet sociale ku vërshojnë urimet për ditëlindje.

## Dua Lipa do të marrë pjesë në koncertin bamirës në Londër



**N**ë Britani të Madhe do të mbahet koncerti për bamirësi, të cilën e organizon Shoqata "Streets of London", ku paratë e mbledhura do të shkojnë për të pastrehët. Koncerti është planifikuar të mbahet në stadiumin legjendar të futbollit "Wembley" të kryeqytetit britanik. Pjesëmarrëse në

këtë koncert do të jetë edhe këngëtarja e famshme Dua Lipa bashkë me këngëtarë të tjerë të famshëm si Llie Goulding, Bastille, Mabel, Sigrid, Grace Carter, Jax Jones dhe Dermot Kennedy. "Streets of London" e organizon këtë koncert të madh çdo vit dhe pothuajse çdo sezon arrin të mbledhë rreth 400 mijë euro.



## Chrissy Metz nis një lidhje të re

**C**hrissy Metz thuhet se ka nisur një lidhje të re. Aktorja 38-vjeçare është duke u takuar me kompozitorin Hal Rosenfeld, raporton "Us Weekly". "Ata janë në lidhje që disa muaj.

Ai është një djalë i mirë dhe Chrissyt i pëlqen shumë", ka treguar një burim për këtë revistë. Chrissy dhe i dashuri i saj i ri u kapën fundjavën e kaluar duke i mbajtur duart së bashku.

## Gruaja e El Kapos tërheq vëmendjen te gjyqi i të shoqit

Gruaja e El Kapos u paraqit në gjykatën e Bruklinit, për ta ndjekur seancën e të shoqit dhe bëri që të kthehen jo pak koka. Me një pamje pothuajse si Kim Kardashian, ajo nuk ka ngurruar të japë deklarata për shtyp në mbrojtje të së shoqit. Ajo ka pasaportë amerikane dhe meksikane për shkak se mamanë e ka amerikane, babanë meksikan. U bë gruaja e tretë e El Kapos sapo mbushi 18 vjeç, e kur ai ishte gati 60 vjeç. Ajo ka lindur dy vajza binjake me bosin meksikan të drogës dhe e ka vizituar vazhdimisht gjatë kohës që ka qenë në burg.



# Kush janë Arbëreshët, ose

Përfaqësojnë një nga grupet etnike më të mëdha në numër përtej Adriatikut. Prej shekujsh ky komunitet i pranishëm para së gjithash në jug, ka ditur të ruajë një specifikë të veçantë: nga gjuha te ritet fetare deri te arti dhe gastronomia. Presidenti Italian Mattarella, duke kujtuar heroin kombëtar Skënderbeu, ka lavdëruar arbëreshët si një “shembull të integritimit dhe mikpritjes”

Arbëreshët ose shqiptarët e Italisë janë një minorancë gjuhësore dhe kulturore e pranishme në anën mesdhetare dhe diellore të Italisë. Në këtë kolektivitet aktiv, të ashtquajtur Arbëri, bëjnë pjesë rreth 100 mijë persona dhe mes tyre, 80%, flet ose kupton gjuhën e vet arbëreshe, ose gjuhën e grupit. Italo-shqiptarët janë të përhapur në disa zona e rajone të ndryshme të vendit: Campania, Molise, Puglia, Basilicata, Sicilia dhe para së gjithash në Calabria, ku është komuniteti më i madh në numër me mbi 58 mijë persona. Nga atdheu-mëmë, Arbëreshët, ruajnë, përveç gjuhës (një mrekulli e vërtetë, nëse konsiderohet se bëhet fjalë për një zakon që reziston prej shekujsh dhe është trashëguar vetëm në mjedise të shtëpisë dhe jo në shkolla), edhe një seri e gjatë traditash fetare, kulturore, gastronomike. Një identitet që qëndron akoma në ritet fetare –

pjesa më e madhe e 50 komuniteteve, ruan deri tani ritin bizantin gjatë liturgjisë – kostume, art dhe gastronomi, të transmetuara brez pas brezi. Shqiptarët e Italisë, bëjnë pjesë pra në atë pasuri të diversiteteve gjuhësore dhe kulturore të pranishme përtej Adriatikut të mbrojtur nga e njëjta Kushtetutë, siç parashikohet nga neni 6 dhe nga një ligj I vitit 1999, që e njeh shqipen mes gjuhëve për t'u vlerësuar.

## Kur erdhën shqiptarët në Itali?

Diaspora shqiptare ka mbërritur mes shekullit XV dhe XVIII, në vijimësi pas vdekjes së heroit kombëtar (Giorgio Castriota Skanderbeg), Gjergj Kastrioti Skënderbeu, (1405-1468). Pavarësisht nga sukseset e tij në fushën ushtarake, udhëheqësi shqiptar nuk arriti të pengojë



Busti i Gjergj Kastrioti Skënderbeut në qendër të Cosenza-s



Tabelë udhëzimi në gjuhën italo-shqiptare, në komunë Maschitto, në provincën e Potenza-s

mbizotërimin otoman dhe Vendi i Shqiponjave, pak nga pak u dorëzua para pushtimit turk. Që këtu do të nisë emigracioni intensiv drejt tokave puljeze, në veçanti në zonat e Otrantos dhe të Capitanata-s. Që atëherë shqiptarët vazhduan të krijonin zona të reja komunitare në mesdhe deri në gjysmën e parë të shekullit të 18-të. Falë mbështetjes së rëndësishme të klerit për të ruajtur një identifikim specifik etnik, në '900 u institucionalizuan dy peshkopata për shqiptarët, një në Sicili dhe një e dytë

që aktualisht ka selinë e saj në Lungro në Calabri. Skënderbeut, i cili u bë simbol i dëshirës për pavarësi nga sundimi i sulltanit, i janë kushuar shumë këngë dhe filma, mes të cilave spikat ajo e Fan S. Nolit (Historia e Skënderbeut, 1921). I publikuar pas Luftës së Parë Botërore, popullariteti i tij ishte i tillë që të gjithë nxënësit e shkollave shqiptare e mësuan pothuajse përmendësh. Ndërkohë, në sheshet kryesore të çdo qyteti, ndodhet i vendosur busti i tij.

Gjuha e tyre është Arbërishtja, një varietet antik-toskë, dialekti mesdhetar shqiptar. Megjithatë, idioma ka pasur një përzierje me greqishten e lashtë dhe dialektin e jugut të Italisë. Një gjuhë, pra, e traditës së lashtë që megjithatë ka qenë në gjendje të kalojë trashëgiminë e saj kulturore gjatë shekujve. Në Kalabri, për shembull, gjuha shqipe përdoret nga rreth 58,000 banorë në 35 komuna. Por shqipja flitet edhe në Puglia (12,800 persona), Sicilia, Molise, Basilicata, Abruzzo dhe Campania. Për fat të keq, në



# shqiptarët e Italisë?



Banorët e Spezzano Albanese (Cosenza) me veshjet tipike të komunitetit arbëresh

takua me homologun e tij shqiptar, Ilir Meta dhe së bashku përruan një pllakë përkujtimore kushtuar Skënderbeut, shumë të dashur nga trashëgimtarët e komunitetit albanofon kalabrez, trashëgimtarë të popullatave të mbërritura shumë vite më parë në Itali.

“Diaspora shqiptare, – kujton Matarella, – identifikohet pikërisht nga Skënderbeu për të mbajtur gjallë lidhjen me atdheun, integrimin në mënyrë paqësore dhe në mënyrë efektive në pjesë të ndryshme të Italisë. Arbëreshët përbëjnë një histori të integritit dhe pranimin që ka pasur sukses të

madh, një shembull se si një marrëdhënie e tillë është kthyer në një mjet të përbashkët mirëkuptimi dhe respekti reciprok të kulturave, teksa janë në rritje për territoret dhe vendet të cilat jetojnë komunitetet e ndryshme”.

“Ruajtja e origjinës së lashtë, ndikimi reciprok, bashkim harmonik i gjuhës, kulturës dhe traditave, – ka shtuar, – kanë qenë për shekuj dhe janë ende vlerë e shtuar e këtyre komuniteteve. Realitete që luajnë një funksion thelbësor të një ure midis dy popujve të ballafaquar, siç shpesh i referohemi shqiptarëve dhe italianëve”.

Marrë nga “Fanpage.it”

## Testamenti i Mid'hat Frashërit, depozituar në Gjykatën e Tiranës më 1929

“TIRANË 4 MARS 1929

Unë, Mid'hat Frashëri, në shëndet trupor të plotë, po bënj këtë testament, duke ushqyerë shpëresën se pas vdekjes' s'ime do të ekzekutohet pikërisht vullneti që dëftën këtu:

1) Çë kam pasuri të tundshme ose të patundshme, libra, mobilla, karta, plaçka, para etj. i lë për krijimin' e një “INSTITUT ALBANOLOGJIE” që të jetë një qëndër e studimeve shqiptare, të mprojë, të shvillojë, të qendrojë dhe të udhëheqjë studimet që përkasin Shqipërinë dhe Shqipëtarët.

2) Dua që nga biblioteka private ime të mos çkëputetë gjë; të gjitha librat të rrinë tok.

3) Gjithë sa më kanë mbeturë nga im atë dhe nga unjë, dhe që sot formojnë muzenë t'ime familiare, dëshëronj që të ruhenë prapë në formë të një muzeje të vogëlë, brënda në INSTITUT.

4) Në paça të holla, në shtëpi, më no një bankë ose hua për të mbledhurë, duke u bashkuarë me sumën që do mirret nga shijtja e Libarisë, dua që të përdorenë të gjitha së bashku.

A) për të bërë spenximet e parë e një godije (shtëpie) e cila të shërbejë si INSTITUT ALBANOLOGJIE, një godi e mjaftë për të nxënë bibliotekën dhe për zyrratë. Dëshira ime është që kjo shtëpi të jetë mjaft' e gjerë sa për të pasur një ose dy oda ku të mundin të bujtin dhe të rrinë musafirë studimtarët albanologë të huaj që vijnë së jashtmi. B) Në qoftë se, në vdekjet t'ime, kam mundurë të godit vetë no një shtëpi, INSTITUTI do të installohet atje. Atëherë të hollat e produktuara, si them më sipër, dotë vihenë në një bankë të sigurtë dhe interesi i tyre, do të përdoret për qëllimin e INSTITUTIT, sidomos për të shtypurë libra ose për të enkuruarë botimin e tyre.

5) Librarija ime dëshëronj që të

shitet ashtu si është, e tërë bashkë, jo copa copa, dhe, në qoftë e mundurë, të mbanjë emërin që i kam dhënë unë.

6) Libravet të INSTITUTIT t'u vihetë vula ime “Biblioteka Lumo Skëndo 1897” dhe t'u ngjitetë Ex-libris. Vula do të gjendetë në tryezën t'ime, në shtëpi, e gatijte, kur se ex-libris është vetëm një skicë bërë prej Hyshref Frashërit.

7) INSTITUTI do të jetë nënë këqyrjen e një Komisioni, bërë prej: a) Drejtorit të Bibliotekës dhe Muze' së Shtetit në Tiranë, (Bibliotekë dhe Muze Kombëtare); b) Kryetarit të Bashkis' së Tiranës; c) Një funksionari të Ministris' s'Arsimit; d) Kryetarit të Diktimit Civil; e) Drejtorit të institutit arsimor shqipëtar më të lartë të Tiranës.

8) Për të zbatuarë testamentin t'im dhe për të ngrehurit e INSTITUTIT lë si të ngarkuarë prej meje këta Zotërinj: Niazi Tirana, Sotir Kolea, Dimitri Berati, Mehdi Frashëri dhe Edhem Fuad Frashëri. Zotit Niazi Tirana i ap barrënë që të kujdesetë edhe si një notabl i Kryeqytetit.

9) Në qoftë se një prej këtyre zotërinjve gjendet absent, për një ose tjetër shkak, në kohët të vdek-

jes' s'ime, atëherë do të zërë vëndin e tij, ose të tyre, Athanas Shundi, farmacist në Tiranë dhe Hasan Toptani, biri i Kurad Toptanit; me të mos ndodhurë më tepër se dy, ata që gjendenë janë të ngarkuarë të zgjedhin aqë anëtarë sa mungojnë prej numurit që shënonj unë.

10) Ngarkonj prapë Baban e Teqes' së Frashërit, Kryetarin e Bashkis' së Frashërit dhe më plakun nga anëtarët e Bashkis' së Frashërit, të kenë mirësinë dhe të kujdesenë për mbarimin' e dëshirës' s'ime që shtroj në këtë testament, do në fillësë të punësë, do edhe çdo mot duke kërkuarë që të botohen edhe çdo mot, duke kërkuarë që të botohetë veprimi dhe bilançoja e INSTITUTIT.

11) Ushqenj besimin e plotë se kjo dëshirë ime do të zbatohetë besnikërisht prej pasanikëve të mij ndë gjithë shekujt që do të vijnë, dhe lutja ime drejtuarë fuqis' së madhe që tani s'e kuptojmë dot, do të jetë të kenë gjithë Shqiptarët idealin e përparimit dhe të naltësimit të Kombit, që Shqiptarizma të bëhetë një dëshirë dhe një konviktim i thellë, dhe që çdokush të kupëtojë se e mira e Kombit ështëë dhe e mira jonë private, se nderi

dhe lavdi i Shqipëtarëve të gjithë, është edhe nderi dhe lavdi ynë personal.

12) Nuk di se ku do të vendoset INSTITUTI; po, në qoftë se goditetë pakëzë jashtë qytetit, do të donja që varri im të jetë në një cep të kopshtit, më të mëngjërë duke hyrë nga porta e rrugësë; mbi këtë varr dua një copë gur të math dhe një qiparis. Më duketë sikur do të jem ruajtësi i INSTITUTIT, sikur do të marr edhe unë një pjesë pasjetore në gjëllimin e tij.

Me këto dëshira dhe shpëresa po e nënëshkruaj me dorën t'ime këtë testament.

Midhat Frashëri

Lumë Skendo

Këtë testament e kam depozituarë ndë Notarijën' e Gjyqit të Shkallëq' së Parë të Tiranës, me datë 4 Mars 1929 dhe me numurë 163.

Kopje të këtij testamenti u kam dorëzuarë Zotërinjvet:

Niazi Tirana, Sotir Kolea, Dimitri Berati, Edhem Fuad Frashëri si dhe Babajt të Teqesë së Frashërit”.

(gazeta-Shqip.com)

dekadat e fundit, komunitetet e arbëreshëve u janë nënshtruar fenomeneve të forta, për më tepër të përhapura në të gjithë jugun, të emigrimit drejt zonave më të urbanizuara, në veri dhe jashtë saj. Në këtë mënyrë, komunitetet që dikur kanë qenë të mbipopulluara, sot janë reduktuar në numër.

Njohja e Arbëreshëve është e tillë, sa që para pak ditësh Presidenti i Italisë Sergio Mattarella, nderoi Gjergj Kastrioti Skënderbeun në vitin e 550 vjetorit të vdekjes së tij. Kreu i Shtetit, kishte udhëtuar në San Demetrio Corone, në krahinën e Cosenza-s, ku u



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

CROATIA - SPAIN

3+

AUSTRIA - BOSNIA-HERZEGOVINA

3+

BELGIUM - ICELAND

3+

## Kosova përfundon stërvitjen e tretë, sot niset për Maltë

Kosova e ka përfunduar edhe stërvitjen e tretë para ndeshjes me Maltën e cila zhvillohet më 17 nëntor. "Dardanët" sot në orën 10:00 nisen drejt Valetas me optimizëm se do ta sigurojnë kualifikimin tutje, kurse më 20 nëntor të festojnë ndaj Azerbajxhanit në stadiumin "Fadil Vokrri"

**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 14 NËNTOR** - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll të mërkurën e ka zhvilluar stërvitjen e tretë para ndeshjes me Maltën e cila zhvillohet më 17 nëntor. Kjo ndeshje është e vlefshme për grupin 3 të Ligës D në Ligën e Kombeve, ku Kosova është e para me tetë pikë dhe me fitore do të kualifikohet në raundin tjetër.

Malta, që është kundërshtarja e "Dardanëve", është skuadra më e dobët në grup, me vetëm dy pikë të grumbulluara. Një nga

lojtarët më të mirë në ekipin e Kosovës, Valon Berisha, i cili aktivizohet me skuadrën e Lazios në Serinë A, ka thënë se futbollistët do ta japin 100-përqindëshin që Kosova ta realizojë objektivin. "Kemi lojtarë shumë të mirë dhe po përgatitemi mirë. Sigurisht se kemi dy ndeshje shumë të vështira para vetes, sidomos kjo kundër Maltës. Shumëçka do të varet nga mentaliteti ynë në këto dy ndeshje. Ne kemi cilësi si ekip dhe me individë shumë të mirë dhe do të shkojmë me synimin për ta dhënë 100-përqindëshin për njëri-tjetrin dhe për

Kosovën", ka thënë Berisha. Për herë të parë i grumbulluar me ekipin përfaqësues të Kosovës është edhe futbollisti Shkëlqim Demhasaj. Sulmuesi i Luzernit, i cili ka luajtur me shpresat e Zvicrës, është mjaft i lumtur që është ftuar nga Kosova dhe me kënaqësi e ka pranuar ftesën. "Më kanë telefonuar nga federata dhe menjëherë e kam shprehur gatishmërinë për të ardhur. Këtu më kanë pritur shumë mirë dhe jam shumë i lumtur që jam pjesë e Kosovës. Tash me rëndësi është që ekipi të përgatitet sa më mirë dhe t'i fitojmë gjashtë pikë. Nuk ka fare



rëndësi se kush luan, por nëse më jepet rasti, si çdo lojtar, do ta jap maksimumin. I kam shikuar të gjitha ndeshjet e Kosovës dhe djemtë kanë luajtur shumë mirë", ka deklaruar Demhasaj. Ekspedita e Kosovës do të niset

drejt Maltës sot (e enjte), kurse stërvitjen e katërt do ta zhvillojë nga ora 18:00 në Valeta. Përfaqësuesja e Kosovës ndeshjen e tjetër dhe të fundit në grup e zhvillon më 20 nëntor në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë.

## Sadiku: Mospjesëmarrja në Botëror, dëshpërim i madh

**PRISHTINË, 14 NËNTOR** - Kampionati Botëror i Boksit nis sot (e enjte) në New Delhi të Indisë, ndërsa pjesëmarrja e ekipit të Kosovës vazhdon të bëhet lajm botëror. Qeveria e Indisë nuk është duke i dhënë vizën hyrëse boksieres Donjeta Sadiku dhe ekipit të saj, me arsyetimin se India nuk e njeh shtetin e Kosovës dhe se nuk mund të lejojnë flamurin e Kosovës në botërorin e Indisë, pavarësisht se ekipi i boksit është pajisur me pasaportën e Shqipërisë. Në zgjidhjen e problemit që ka marrë përmasa globale janë përfshirë edhe Komiteti Olimpik Ndërkombëtar (IOC), Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK), Komiteti Olimpik i Indisë (KOI) dhe Federata e Boksit e Indisë (FBI) si organizatore e botërorit. "Nuk është vetëm çështje e boksit, është problem global", ka thënë Ajan Singh, president i FBI-së në konferencën për shtyp.

Komiteti Olimpik i Indisë përmes një letre të ashpër të dërguar sot ka kërkuar nga Ministria e Sportit



e këtij vendi t'ia japë vizën ekipit të Kosovës. "Është e nevojshme që menjëherë të merren veprimet nga autoritetet indiane për t'u siguruar sportistëve dhe delegacionit nga Kosova pjesëmarrjen në Kampionatin Botëror të Boksit dhe të trajtohen në kushte të njëjta si çdo pjesëmarrës tjetër, pa asnjë diskriminim, në përputhje me vlerat dhe qeverisjen e Lëvizjes Olimpikë në mbarë botën", thuhet në letrën e presidentit të KOI-të, Narinder Batra, shkruan "Sportskeeda.com". I pari i KO të Indisë ka paralajmëruar qeverinë e këtij vendi se dështimi për t'i siguruar hyrjen ekipit të Kosovës do të raportohet në të gjitha organizatat sportive

ndërkombëtare të interesuara për të organizuar ngjarje të rëndësishme ndërkombëtare në Indi. Në presion qeveria indiane është vënë edhe nga mediat e ndryshme botërore. Donjeta Sadiku prej një viti është duke u përgatitur për këtë botëror, që është gara më e rëndësishme dhe që vlen për pikë kualifikuese për Lojërat Olimpikë "Tokyo 2020". Për të njëjtën arsye, dhe po nga shteti i Indisë, asaj nuk iu dha viza për botërorin e juniorëve të mbajtur në dhjetor të vitit të kaluar. "Jam duke stërvitur vazhdimisht dhe ende nuk e kam humbur shpresën. Nëse nuk më japin vizën do të jem thellësisht e dëshpëruar, pasi është hera e dytë që më ndodh i njëjti problem. Jam përgatitur mirë dhe nëse marrë pjesë besoj shumë në medalje. Kjo garë do të më ndihmonte për Lojërat Olimpikë "Tokyo 2020". Të humben dy kampionate të tilla është dëshpërim i madh", ka thënë Donjeta për uebfaqen zyrtare të KOK-ut, "noc-kosovo.org".

## Ylli - Trepça përballen sonte në '13 Qershori'

**PRISHTINË, 14 NËNTOR** - Xhiroja e nëntë në Superligën e Kosovës në basketboll do të nisë sot (e enjte) me dy ndeshje që do të zhvillohen, njëra në Suharekë, tjetra në Pejë. Në Suharekë do të takohen Golden Eagle Ylli - Trepça me fillim nga ora 19:00 në palestrën "13 Qershori", kurse në "Karagaçi" të Pejës, Borea është nikoqire e Ponte Prizrenit. Golden Eagle Ylli në tetë ndeshje të luajtura deri më tani ka regjistruar pesë fitore e tri humbje, kurse Trepça ka bilanc

prej dy fitoresh e gjashtë humbesh. Borea në tetë xhiro ka realizuar dy fitore e gjashtë humbje, derisa Ponte Prizreni në shtatë ndeshjet e luajtura ka bilanc prej katër fitoresh e tri humbesh. Të premten është në program dueli në mes të Lipjanit dhe Z Mobile Prishtinës që do të luhet në kryeqytet me fillim nga ora 19:00, kurse të shtunën do të zhvillohet takimi i xhiros së nëntë, ai në mes të Bashkimit dhe Rahovecit, duke filluar nga ora 19:00.



## Lenjani humb ndeshjen ndaj Skocisë

**TIRANË, 14 NËNTOR** - Trajneri i Kombëtares së Shqipërisë, Christian Panucci është duke u

përballur me disa mungesa të futbollistëve para ndeshjes ndaj Skocisë më 17 nëntor.

Lojtari i fundit që është larguar nga kombëtarja kuqezi është Ermir Lenjani, i cili do të

mungojë si pasojë e lëndimit të pësuar në skuadrën e Sionit, prandaj është kthyer në Zvicër

dhe në këtë mënyrë e humb ndeshjen e Ligës së Kombeve ndaj Skocisë.

## Januzaj: Mourinho nuk më dha asnjë rast

MANCHESTER, 14 NËNTOR - Futbollisti shqiptar i Real Sociedadit, Adnan Januzaj, është kthyer të flasë për kohën kur ishte pjesë e Manchester Unitedit. Januzaj e ka akuzuar trajnerin Jose

Mourinho se nuk i ka dhënë asnjë rast për ta dëshmuar vetën në United. "Unë nuk kam pasur asnjë shans, sepse në atë kohë Mourinho ndoshta donte lojtarë më me përvojë si emra", ka thënë Januzaj.

Reprezentuesi i Belgjikës më pas konfirmon se është i lumtur te skuadra e Real Sociedadit. "Për mua nuk ishte problem. Kisha për të lëvizur dhe tani jam i lumtur në Spanjë. Gjithmonë e dija

se kisha kualitetin për të luajtur te Manchester Unitedi. Atje nuk ma dhanë një shans, por nuk është problem. Jam i lumtur në Spanjë dhe po shijoj futbollin tim", ka deklaruar Januzaj.



## Veseli: Shqipëria nuk bie nga Liga C

TIRANË, 14 NËNTOR - Frederik Veseli me shumë gjasë do të luajë si mbrojtës i djathtë në ndeshjen me Skocinë. Në mungesë të Hysajt për shkak kartonësh, mbrojtësi i Empolit pritet që ta zërë vendin e tij në linjën e djathtë. Veseli theksoi se ai dhe skuadra nuk e mendojnë rënien nga Liga C. 25-vjeçari ka treguar se situata në skuadër është e mirë dhe besimi është i madh se ndaj Skocisë do të arrihet një rezultat pozitiv për ta zënë vendin e dytë. "Jam gati dhe jam rikthyer nga dëmtimi prej dy javësh. Kam punuar shumë dhe them se jam gati për këto ndeshje. Kemi disa mungesa dhe do të shohim. Do të jap më të mirën nëse do të jem në fushë. Them se e kam lënë pas krahëve dëmtimin", ka thënë Veseli. "I kemi pësuar disa gola që mund t'i evitonim. Janë disa gjëra pozitive dhe disa gjëra negative që duhet t'i përmirësojmë. Të insistojmë te gjërat pozitive dhe ta gjejmë rrugën drejt suksesit për këto dy ndeshje. Kam luajtur shumë herë në të djathtë dhe nuk do të jetë problem për mua. Nëse më cakton trajneri aty, do ta jap më të mirën. Duke qenë se jam pak më shumë defensiv, varet nga trajneri. Unë do të jap maksimumin gjithnjë", ka shtuar Veseli, i cili ka lavdëruar edhe paraqitjet e disa prej futbollistëve kuqezij në skuadrat ku



aktivizohen. "Besoj se në mënyrë individuale them jemi në mënyrë të mirë, si ne lojtarët e mbrojtjes ashtu dhe në sulm. Gredza ka shënuar, Binaku, unë e Gjimshiti kemi luajtur. Uroj që ky moment pozitiv të na shtyjë para dhe të arrijmë një fitore ose një rezultat pozitiv në këto dy ndeshje", ka thënë ai.

Mbrojtësi Veseli nuk beson se Shqipëria do të bjerë nga Liga C. "Ne nuk kemi presion. Kemi mentalitetin për të dhënë më të mirën dhe të shkojmë në vendin e dytë. Nuk e kemi menduar se do të biem nga Liga C. Ne besojmë se do ta arrijmë vendin e dytë", ka përfunduar Veseli.

## Golden State dominon në perëndim, Clevelandi rikthehet te fitorja

OAKLAND, 14 NËNTOR - Golden State rikthehet te fitorja në NBA pas triumfit 110-103 ndaj Atlantës, ndeshje me emocione dhe rivalitet në shumicën e kohës. Vetëm në periodën e katërt vendësit arritën të shkëputen e fitojnë, ku diferencën në fushë e bëri Durant, autor i 29 pikëve, ndërsa Thompsoni e mbylli me 24 pikë (vazhdon të mungojë Curry, i dëmtuar). Suksesi mban ekipin e Warriorsit në krye të renditjes në Konferencën e Perëndimit. Skuadra e Houstonit mposhti 109-99 rivalët e Denverit, sfidë ku ekipet dueluan deri në fund për fitoren. Denveri nuk arriti të përfitojë nga faktori fushë, me Morrisin që realizoi 19 pikë, ndërsa për Houstonin u dalluan Capela (24 pikë), Hardeni (22 pikë) e 11 asistime) e Pauli (21 pikë). Rikthehet te fitorja Clevelandi, që korri fitoren e



dytë sezonale. Nënkampionët e NBA-së mundën 113-89 Charlotten, sfidë e komanduar nga Cavaliersi, me 6 lojtarë që realizuan mbi 10 pikë. Clarkson ishte shënuesi më i mirë me 24 pikë.

### REZULTATET

Cleveland - Charlotte 113-89  
Denver - Houston 99-109  
Golden State - Atlanta 110-103

### SHKURT

#### Miqësorja Turqi - Ukrainë u besohet gjyqtarëve të Kosovës

Katërshtja e gjyqtarëve të Kosovës, Genc Nuza, Fatlum Berisha, Bujar Selimaj dhe Besfort Kasumi, do ta ndajnë drejtësinë në ndeshjen miqësore ndërmjet Turqisë dhe Ukrainës. Kjo miqësore do të zhvillohet më 20 nëntor në stadiumin "Antalya Stadium" të Turqisë. Kështu kanë njoftuar të mërkurën mediet në Turqi.

#### Ranieri, trajner i Fulhamit

Trajneri italian Claudio Ranieri është emëruar trajner i ri i Fulhamit, duke e zëvendësuar trajnerin e shkarkuar serb, Slavisa Jokanović. Ranieri, i cili e fitoi Premierligën me Leicester Cityn në sezonin 2015-16, do ta zëvendësojë serbin në "Craven Cottage". Fulhami njoftoi se Ranieri ka nënshkruar kontratë 'shumëvjeçare' dhe për detyrë do ta ketë ta shpëtojë klubin nga rënia prej Premierligës.

#### Dy klube angleze e kërkojnë Herreran

Athletico Madridi dhe Athletic Bilbao kanë shfaqur interesim për mesfushorin e Manchester Unitedit, Ander Herrera, kontrata e të cilit përfundon në muajin qershor të vitit të ardhshëm. Edhe pse së fundmi është folur se "Dajti" i kanë ofruar rinovimin 29-vjeçarit, për momentin mes palëve nuk kanë nisur bisedimet, çfarë do të thotë se, duke nisur që nga muaji janar, përfaqësuesit e mesfushorit mund të kontaktojnë me një klub tjetër, e më pas, nëse arrihet një akord, në qershor ai mund të largohet me parametra zero.

#### Modriqi: Për Realin asgjë nuk është e pamundur

Mesfushori Luka Modriq ka treguar besimin e plotë se Real Madridi mund ta fitojë sërish Ligën e Kampionëve, ndonëse nuk ka bërë një nisje sezoni mbresëlënëse. "Në futboll asgjë nuk është e pamundur, sidomos për Realin e Madridit, diçka që e kemi treguar. Pse të mos e fitojmë edhe Ligën e Kampionëve për herë të katërt radhazi? Duhet të përmirësohemi me lojën tonë. Gjëja më e rëndësishme është se në çfarë pozicioni do të jemi në fund të edicionit. Do të punojmë shumë për t'u ngjitur sa më lart. Ne synojmë të fitojmë titullin por, para së gjithash, të bëjmë një lojë të bukur", ka thënë Modriqi.

#### Ja pse u rrëzua helikopteri që ia mori jetën pronarit të Leicesterit

Ka filluar të zbardhet rasti i rrëzimit të helikopterit jashtë stadiumit të Leicesterit, 'King Power'. Nga rrëzimi i helikopterit jashtë stadiumit të Leicesterit humbi jetën edhe pronari i 'Dhelprave', Vichai Srivaddhanaprabha. Kompania e avionit ka filluar hetimet e para, duke dyshuar se piloti kishte probleme në pedalin e komandës. Sipas Bordit për Hetim të Aksidenteve Ajrore (AAIB), ata kanë kërkuar që të gjithë helikopterët e këtij lloji të hetohen për atë defekt, në mënyrë që të kenë një pistë të qartë të hetimeve. Sipas kësaj kompanie, helikopteri mori kthesë në anën e djathtë, edhe pse piloti kishte shtypur atë për anën e majtë. Pesë persona humbën jetën në këtë aksident tragjik - Vichai, dy anëtarë të stafit të tij, Kaveporn Punpare dhe Nusara Suknamai, piloti Eric Swaffer dhe pasagjerja Izabela Roza Lechowicz.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo unutrašnjih poslova / Ministry of Internal Affairs

Ministria e Punëve të Brendshme, duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-076 për Policinë dhe Udhëzimin Administrativ nr.13/2012-MPB për Themelimin, Përbërjen dhe Procedurat e Komisionit për Emërime të Larta në Polici, ri shpall:

## KONKURS

**Titulli i postit:** Zëvendës drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës

**Referenca:** MPB-ZV. DP/02

**Kohëzgjatja:** Pesë (5) vjeçare, me mundësi vazhdimi pas çdo pesë (5) vjetëve nga autoriteti që e emëron.

**Vendi i punës:** Prishtinë

**Raportimi:** Zëvendës drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës i raporton dhe i përgjigjet drejtpërdrejtë Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës.

**Niveli i pagës:** Sipas Ligjit në fuqi

**Orari i punës:** I plotë

**Përgjegjësi për Menaxhim ekzekutiv:** Po

**Funksionet dhe përgjegjësitë:**

1. Ushtron detyrat dhe autorizimet e Drejtorit të Përgjithshëm në mungesë të tij, në pamundësi të paraqitjes së tij apo me kërkesën e tij.
2. Ndihmon në përbushjen e funksioneve të Drejtorit të Përgjithshëm ashtu siç udhëzohet nga Drejtori i Përgjithshëm;
3. Ushtron edhe funksione të tjera të cilat i përcakton Drejtori i Përgjithshëm pas miratimit nga Ministri;

**Aftësitë, përvoja dhe atributet tjera që kërkohen:**

- Shkathtësitë e dëshmuara të menduarit strategjik, planifikimit dhe implementimit;
- Të ketë aftësi të koordinimit dhe kontrollimit;
- Aftësia e dëshmuar për analizimin e nevojave për aftësim, përcaktimin e zgjidhjeve të duhura, monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së intervenimeve;
- Të ketë shkathtësi të shkëlqyeshme të organizimit, duke punuar në një ambient nën presion;
- Të ketë shkathtësi të dëshmuara dhe efektive të komunikimit me shkrim dhe me gojë;
- Të ketë aftësi të shkëlqyeshme ndër personale të menaxhimit dhe negocimit;
- Të posedojë aftësi për punë ekipore.

**Kualifikimet e kërkuara:**

- Diplomë universitare nga një universitet i akredituar ose të ketë diplomë të nostrifikuar;
- Kandidati/ja duhet të njohë ndonjërin nga gjuhët zyrtare në shkrim dhe lexim, ndërsa njohja e gjuhës angleze është përparësi.

**Kushtet e veçanta:**

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të mos ketë qenë i dënuar për veprë penale, me vendim të formës së prerë.
- Të mos jetë i ndëshkuar për shkelje të rëndë disiplinore sipas rregullores disiplinore të policisë apo rregullores së institucioneve tjera shtetërore brenda dhjetë (10) viteve të fundit që është ekuivalente me shkeljet që përcaktohen në rregulloren e disiplinës së Policisë së Kosovës;
- Të ketë gradën policore kolonel, nënkolonel ose major, së paku pesë (5) vite;
- Secili kandidat duhet të mos ketë konflikt interesi me detyrën apo si parashihen me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e funksioneve Publike;
- Secili kandidat për këtë pozitë duhet t'i nënshtrohet verifikimit të sigurisë sipas ligjit të aplikueshëm;
- Kandidatët duhet të ofrojnë një letër interesi lidhur me motivet që e shtynë kandidatin për të konkurruar, si dhe CV-në e tij.

Kandidatët duhet të shkarkojnë, plotësojnë dhe përfshijnë dokumentin e Listës Kontrolluese. Kjo listë mund të shkarkohet në linkun: <https://mpb.rks-gov.net/DocumentsMundesiPuncsimi/Lista%20kontrollucse%20e%20dokumente%20q%20duhet%20ta%20shoq%20C3%ABrojn%20C3%AB%20aplikacionin%20tuaj.pdf>;

**Mënyra e aplikimit:**

Formularët për aplikim mund të merren në recepcion të MPB-së, ose të tërhiqen nga web faja e MPB-së, ku është bërë edhe shpallja e konkursit, në adresën [www.mpb-rks.org](http://www.mpb-rks.org) dhe dorëzohen në Divizionin e Burimeve Njerëzore, ose nëpërmjet postës elektronike ([ahmet.sh.gashi@rks-gov.net](mailto:ahmet.sh.gashi@rks-gov.net)) dhe postës, në adresën: Divizioni i Burimeve Njerëzore, Rr.

Luan Haradinaj p. n (afër stadiumit) Prishtinë, çdo ditë punë nga ora 08:00 deri në 16:00. Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore dhe në uebfaqen e MPB-së duke filluar nga data 15.11.2018 deri më 29.11.2018.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni me z. Ahmet Gashi, nr. tel. 038-200 19 548.

**Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten:**

- Kopja e letërnjoftimit ose pasaportës;
- Kopjet e dokumentacionit për kualifikim të studimeve themelore;
- Dëshmi mbi gradën Major, Nënkolonel apo Kolonel për 5 vjet;
- Certifikata nga evidenca e personave kundër të cilëve është duke u zhvilluar procedura penale dhe personave të dënuar nga Gjykata e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se 6 (gjashtë) muaj;
- Dëshmi nga institucioni kompetent që nuk është i ndëshkuar për shkelje të rëndë disiplinore në dhjetë (10) vitet e fundit;
- Deklarata nga kandidati me të cilën deklarohet se nuk ka konflikt interesi me detyrën e Zv. Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës ashtu siç parashihet në Ligjin për Policinë dhe Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksioneve publike, deklaratë e cila duhet të ketë datën dhe nënshkrimin e deklaruës;
- Kandidatët që posedojnë certifikatën e sigurisë, të ia bashkëngjisin një kopje të saj aplikacionit;
- Letër interesi dhe
- Aplikacionit t'i bashkëngjitet edhe biografia (CV-ja).

Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhje të ngushtë, do të informohen lidhur me intervistën nëpërmjet telefonit ose me shkrim, në afat ligjor, nga personeli i Divizionit të Burimeve Njerëzore.

Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur dhe të ftuar në intervistë, duhet të sjellin për shikim (konfirmim) të gjitha dokumentet origjinale. Kërkesat e dërguara pas datës së fundit të mbylljes së shpalljes nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen.

Ministria e Punëve të Brendshme i shërben gjithë popullit të Kosovës. Ajo i inkurajon aplikacionet prej femrave dhe meshkujve, dhe pa dyshim, inkurajon të gjitha grupet etnike minoritare në Kosovë.

Ky proces rekrutimi do të monitorohet nga përfaqësuesit e Projektit Britanik për Emërime të Larta. Kështu që kandidatët informohen që rangimi dhe poentimi i tre kandidatëve më të vlerësuar në këtë garë mund të publikohen në uebfaqen e projektit dhe me rastin e aplikimit për këtë pozitë do të konsiderohet që është leja që këto të dhëna të publikohen.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Valmir Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII SHFMU "Xhevat Berisha" Prizren.

► Bahri Hoxha shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII SHFMU "Dy Dëshmorët" Piranë.

► Fatmir Shala shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX SHFMU "Dy Dëshmorët" Piranë.

► Auto Servis Valmiri, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit më numër: 80459980, Vushtrri.

► Nuri Qollopeku shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHMM "Luciano Motroni" Prizren

► Bashkëpronarja Vesna Grujic shet pjesën e vetë ideale në parcelën kadastrale P-70202018-00001K-0 Zona Kadastrale Gojbule Komuna e Zveçanit. Ftohen bashkëpronaret që nëse janë të interesuar për blerje të kësaj prone të lajmërohen te i autorizuar i saj Savic Dimitrije nga Zveçani.

► Urgjentisht kërkohet banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhomë gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

► Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.

► Urgjentisht kërkohet banesë me qira ne Prishtine, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhomë gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

► Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

► Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

**Lëshoj shtëpinë me qira, e cila gjendet në lagjen e "Universiteti" përball rrugës B dhe përball marketit Viva Fresh Store. Shtëpia është 100 metra katror dhe e mobiluar. Është e përshtatshme për zyre dhe banim. Numri kontaktues 049-574-169.**



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo unutrašnjih poslova / Ministry of Internal Affairs

Ministarstvo unutrašnjih poslova na osnovu Zakona br. 04 / L-076 o policiji i Administrativnog upustva br. 13/2012-MUP o osnivanju, sastavu i procedurama Komisije za viša policijska imenovanja, ponovo objavljuje:

## KONKURS

**Naziv posta:** Zamenik generalnog direktora Kosovske policije

Referenca: MUP-ZGDP / 02

**Trajanje:** pet (5) godina sa mogućnoću obnavljanja svakih pet (5) godina od strane organa za imenovanja

**Mesto:** Priština

**Izveštavanje:** Zamenik generalnog direktora izveštava i odgovara direktno generalnom direktoru kosovske policije.

**Nivo plate:** Prema važećem zakonu

**Radno vreme:** Puno

**Odgovornost izvršnog rukovodstva:** Da

### Funkcije i odgovornosti:

1. Obavlja dužnosti i ovlašćenja generalnog direktora u njegovom odsustvu, u nemogućnosti da se pojavi ili na njegov zahtev.
2. Pomaže u obavljanju funkcija generalnog direktora u skladu sa instrukcijama generalnog direktora;
3. Takođe vrši i druge funkcije koje određuje generalni direktor nakon odobrenja od strane ministra;

### Potrebne veštine, iskustvo i drugi atributi:

- Dokazane veštine o strateškom mišljenju, planiranju i implementaciji;
- Veštine za koordinaciju i kontrolu;
- Dokazana sposobnost za analiziranje potreba za obukom, određivanje odgovarajućih rešenja, praćenje i ocenjivanje kvaliteta intervencije;
- Odlične sposobnosti za organizovanje, radeći u okruženju pod pritiskom;
- Dokazane i efikasne veštine u pisanoj i usmenoj komunikaciji;
- Pdllične lične menadžerske veštine i veštine pregovaranja;
- Posedovanje veština za timski rad.

### Potrebne kvalifikacije:

- Univerzitetska diploma sa akreditiranog univerziteta ili diplomu sertifikovanog;
- Kandidat treba da zna jedan od službenih jezika u pisanju i čitanju, a prepoznavanje engleskog jezika je prednost.

### Posebni uslovi:

- Da bude državljanin Republike Kosova;
- Da ne bude osuđen za krivično delo konačnom odlukom, (molimo dostavite sertifikat da niste u istrazi izdat ne više od 6 meseci prije datuma podnošenja zahteva);
- Da ne bude kažnjen za teške disciplinske prekršaje prema disciplinskim propisima policije ili propisima drugih državnih institucija u poslednjih deset (10) godina, što je ekvivalentno krivičnim delima utvrđenim u propisu o disciplini Kosovske policije;
- Imati čin pukovnika, potpukovnika ili poručnika najmanje pet (5) godina;
- Svaki kandidat ne bi trebao imati sukob interesa sa zadatkom ili kao što je predviđeno Zakonom o sprečavanju sukoba interesa u vršenju javnih funkcija;
- Svaki kandidat za ovu poziciju podleže proveru sigurnosti prema važećem zakonu;
- Kandidati bi trebali dati pismo od interesa u vezi sa motivima koji su doveli kandidata da se takmiči, kao i njegov CV.

Kandidati moraju preuzeti, popuniti i pridodati dokument za proveru. Ova lista može se preuzeti sa ..... (link na sajt Ministarstva); <https://mpb.rks.gov.net/DocumentsMundesiPunesimi/Kontrolna%20lista%20dokumenata%20koji%20moraju%20pratiti%20va%C5%A1u%20aplikaciju.pdf>;

### Način konkurisanja:

Obrasci za konkurisanje se mogu uzeti na recepciji MUP-a u Prištini ili da se izvuku sa web stranice MUP-a gde je i objavljen konkurs, na adresi [www.mpb-rks.org](http://www.mpb-rks.org) i predaju se u Kancelariji za ljudske resurse, ili elektronskom poštom ([ahmet.sh.gashi@rks-gov.net](mailto:ahmet.sh.gashi@rks-gov.net), ili poštom na adresi: Divizija za ljudske resurse, Ul. Luan Haradinaj, b.b. (kod gradskog stadiona) Priština, svakog radnog dana od 8:00 - 16:00. Konkurs je otvoren 15 dana nakon objavljivanja u dnevnim novinama od 29.11.2018.

Za dodatne informacije kontaktirajte g. Ahmet Gashi, br. tel. 038/200 19 548.

Aplikaciji treba priložiti: fotokopiju lične karte, kopije dokumentacije za kvalifikacije osnovnih studija, dokaza vojne čin majora, potpukovnika ili pukovnika za pet godina, Uverenje o licima protiv kojih se vodi krivični postupak i osuđenih od suda, dokazi iz nadležne institucije da nije kažnjen za težeg disciplinskog prekršaja u deset (10) zadnjih godina, izjava od kandidata kojom izjavljuje da ne postoji sukob interesa sa pozicije Zg. direktora Kosovske policije, kao što je predviđeno u Zakonu o policiji i Zakon o sprečavanju sukoba interesa u vršenju javnih funkcija, izjavu koja mora imati datum i potpis u deklaraciju.

Kandidati koji ulaze u bliskoj selekciji biće obavešteni o intervjuu telefonom ili pismenim putem u zakonskom roku od strane osoblja odeljenja za ljudske resurse. Kandidati koji poseduju sigurnosni sertifikat pripisuju njegovu kopiju aplikaciji.

Kandidati koji će biti izabrani i pozvani na intervju trebalo bi da daju sve originalne dokumente na uvidu (potvrdu). Zahtjevi poslati nakon poslednjeg datuma objavljivanja oglasa neće biti prihvaćeni. Nepotpuni zahtevi mogu biti odbijeni.

Ministarstvo unutrašnjih poslova služi svim ljudima Kosova. Ona podstiče apliciranje žena i muškaraca, i bez sumnje sve manjinske etnike grupe na Kosovu.

Ovaj proces zapošljavanja će biti monitorisan od strane predstavnika Britanskog projekta za visoka nominacija. Tako se kandidati obaveštavaju da je rangiranje i bodovanje tri najboljih kandidata na ovom takmičenju mogu se objaviti na veb stranici projekta i u slučaju apliciranja za ovu poziciju, smatraće se da je data dozvola za objavljivanje ovih informacija.



## OFERTË PËR SHITJE TË SHTËPISË

Shitet shtëpia dykatëshe, me sipërfaqe prej 218 m<sup>2</sup>, dhe trualli me sipërfaqe prej 410 m<sup>2</sup>.

Shtëpia gjendet në Prishtinë, në lagjen "Aktash I", rr. "Ferhat Draga" nr. 1.

Procedura e transaksionit nga shitësi te blerësi bëhet pas nënshkrimit të kontratës së shitblerjes dhe pagesës së çmimit të kontraktuar, pastaj paluejtshmëria e përshkruar më lart kalon te blerësi.

Çmimi sipas marrëveshjes.

**Informata më të hollësishme  
mund të merren në numrin e telefonit  
001-347-331-8305 në Nju Jork, kurse në Prishtinë  
në celularin 044-166-580.**



Sot mbushen shtatë ditë që kur u nda nga jeta babai e gjyshi ynë i dashur

## Prof. Xhevat (Hamdi) Musliu

(1941-2018)

Ti ike nga kjo botë por le pas vete shumë vepra jetësore të shkruara e të kujtuara përjetë. Ishe simbol i punës, vullnetit, bujarisë e fisnikërisë njerëzore udhërrëfyese ynë!!!

Mburremi dhe krenohemi për jetë për ty o babë!!  
**E kujtojnë me mall: gruaja Kimeti, vajzat Flora e Teuta, djemtë Përparimi e Lulzimi, rejat Senada e Merita si dhe mbesat e nipat nga Prishtina.**

### DOLI NË SHITJE LIBRI EKSKLUZIV I AUTORIT FATON MEHMETAJ, "VEPRIMTARIA E SHËRBIMEVE SEKRETE RUSE NË SHTETET E BALLKANIT"

Libri më i ri i studiuesit dhe njohësit të mirë të çështjeve të sigurisë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, Faton Mehmetaj, "Veprimtaria e shërbimeve sekrete ruse në shtetet e Ballkanit",

sjellë të dhëna dhe dëshmi tronditëse mbi shtrirjen dhe veprimtarinë e shërbimeve sekrete ruse në Ballkan.

- Si tentuan shërbimet ruse ta destabilizojnë Kosovën?
- Si tentuan grusht shtetin në Mal të Zi, në Shqipëri e Maqedoni?
- Cilat janë shërbimet ruse që operojnë në Ballkan?
- Cilat janë format dhe metodat e shërbimeve sekrete ruse për të destabilizuar rajonin?
- Cila është strategjia e tyre operuese?
- Si ndikuan këto shërbime nëpërmjet medieve, politikës, ekonomisë, të fuqizojnë politikanë dhe struktura politike për t'i pozicionuar në strukturat më të larta të shteteve të rajonit për të mbrojtur interesat pro-ruse?

Përgjigjet në këto pyetje dhe në shumë e shumë pyetje të tjera i gjeni në librin ekskluziv "VEPRIMTARIA E SHËRBIMEVE SEKRETE RUSE NË SHTETET E BALLKANIT", një studim hulumtues, i autorit Faton Mehmetaj, i pari i këtij lloji dhe njëherësh ndër librat më të kërkuar nga lexuesit, ku nxirret lakuriq veprimtaria destabilizuese e shërbimeve ruse në rajon.

Libri përmban 214 faqe dhe është botim i përbashkët i Institutit për Studime Gjeopolitike dhe Siguri (ISGJS) dhe Gazetës së Përditshme Shqiptare "EPOKA E RE", në Prishtinë.



C.nr.536/2018

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË,** departamenti i përgjithshëm, gjyqtari Naim Mehollli në çështjen juridike të paditësit: Shkelzen Pllana nga fsh. Kqiq i Madhë Komuna e Mitrovicës të cilin sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson Av. Sabit Pllana nga Mitrovica kundër të paditurit: Maria Magdalena Sprengel nga Polonia tani me adresë të panjohur, gjykata me datën: 13.11.2018 konform nenit 79.3 të LPK-së mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. Caktohet Av. Zeqir Maxhuni** nga Mitrovica si përfaqësues i përkohshëm i të paditurës: Maria Magdalena Sprengel nga Polonia tani me adresë të panjohur.

**II.** Përfaqësuesi i përkohshëm në kuptim të nenit 82 të LPK-se, i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjorë, të cilat i ushtron deri sa të paraqiten në gjykatë të paditurit apo përfaqësuesi me prokurë, respektivisht deri sa organi i kujdestarisë ta njoftoj gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

**III.** Ky aktvendim në afat prej shtatë ditësh të shpallet në tabelën e shpalljes së gjykatës, të botohet në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, si dhe te botohet në njërin nga gazetatat ditore të Kosovës apo sipas nevojës të shpallet në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme.

**IV.** Shpenzimet për përfaqësuesin e përkohshëm bien në barë të palës paditëse.

**A r s y e t i m**

Paditësit Shkelzen Pllana nga fsh. Kqiq i Madhë Komuna e Mitrovicës të cilin sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson Av. Sabit Pllana nga Mitrovica, ka parashtruar padi kundër të paditurës si më lartë.

Gjykata duke u bazuar në të dhënat si në padi në bazë të cilave konstatohet se pala paditëse nuk posedon adresën e saktë të paditurës, dhe duke marr për bazë faktin se e paditura nuk është me shtetësi kosovare, gjykata nuk mundi të kërkoj shënime nga organet relevante vendore.

Vendimin për përfaqësues të përkohshëm gjykata e mori duke u bazuar në deklarin e palës paditëse se i njëjti nuk ka adresë të saktë të palës së paditur, gjykata pas konsultimit me Odën e Avokatëve të Kosovës rreth emrit kujdestar për konsultimit me Odën e Avokatëve të Kosovës cekura si më lartë: Maria Magdalena Sprengel nga Polonia tani me adresë të panjohur iu caktua përfaqësuesi i përkohshëm Av. Zeqir Maxhuni nga radhët e avokatëve të rajonit të Mitrovicës.

Pas shqyrtimit të propozimit të autorizuarit të palës paditëse, gjykata vlerësoi se ky propozim për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm të paditurës së cekur më lartë është i bazuar pasi që janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore të parapara me nenin 79.3 pika a) të LPK-se, ndërsa për përfaqësues të përkohshëm pas konsultimit me Odën e Avokatëve të Kosovës lidhur me avokatin kujdestar me dt.13.11.2018 ka caktuar Av. Zeqir Maxhuni nga Mitrovica.

Përfaqësuesi i përkohshëm në kuptim të nenit 82 të LPK-se, i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjorë, të cilat i ushtron deri sa të paraqiten në gjykatë të paditurit apo përfaqësuesi me prokurë, respektivisht deri sa organi i kujdestarisë ta njoftoj gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

Nga se u tha më lartë konform nenit 79.3/1, neni 82.1.2 si dhe nenit 387.1 të LPK-së vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
C.nr.536/2018 me datë 13.11.2018

**GJYQTARI,**  
Naim Mehollli

**UDHËZIM JURIDIK** - Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada-Government  
Ministria e Drejtësisë-Ministraskvo Pravde-Ministry of Justice



Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar / Agjencia za Upravljanje Zoplenjenom i Konfiskovanom Imovinom/ Agency for Administration of Sequestrated and Confiscated Assets

**Ftesë për Ankand Publik**

Datë 14.11.2018

Referenca: AAPSK - 008/2018

AAPSK- njofton të gjithë të interesuarit se ofron për shitje mallin si në vijim, sipas lëndës së paraqitura më poshtë:

Nr	Përshkrimi	Sasia/copë	Çmimi Fillestar/copë	Çmimi nga ofertuesi	Çmimi total €
1	Nissan, viti i prodhimit 1993, benzin, ngjyre e gjelbër metalike- për skrap	1 copë/ për skrap	147.90€		
2	Golf III, dizel, ngjyre e kuqe-për skrap	1 copë/për skrap	180.20€		
3	Kamion Man, ngjyre e bardhe-për auto pjesë	1 copë/ auto-pjesë	2,000.00€		
4	Kamion Renault G-330, viti i prodhimit 1990,dizel, ngjyre e bardhe-për auto pjesë	1 copë/ auto-pjesë	1,400.00€		
5	Skoda Octavia,viti i prodhimit 2007, benzin,ngjyre e hirit e mbyllur-për auto pjesë	1 copë/ auto-pjesë	450.00€		
6	Ford Focus, viti i prodhimit 2007, me targa të huaja, ngjyre e kaltër- për auto pjesë	1 copë/ auto-pjesë	450.00€		
7	Alfa Romeo 147 viti i prodhimit 2002, ngjyre gri e errët- për auto pjesë	1 copë/ auto-pjesë	300.00€		
8	Audi S6, viti i prodhimit 2001, bezin, targa vendore, ngjyra e katërt	1 copë	1,500.00€		
9	Një makinë për paketim me vakum "Komet-Plus Vac 21"; një peshore First Fa-6404 dhe një peshore Ilyndai	3 copë	250.00€		
10	Aparat për distilimin e ujit Ilojtit, DZ 20 litra	1 copë	150.00€		

Oferta e nënshkruar, vulosur dhe e mbyllur në zarf duhet të dorëzohen më së largu deri më 21.11.2018 në ora 10:00h, në lokalct e AAPSK-së, Divizioni i Shitjes (në adresën e poshtëshënuar). Të interesuarit mallin mund ta shikojnë me datë: 19.11.2018, prej orës 10:00-11:00 në Depon e Agjencisë në fshatin Llukar KK Prishtinë.

Pasurit e konfiskuara në këtë procedurë shitje procedohen për shitje, me çmimin e lartë cekur në gjendjen siç janë. Vërejtje:Vetura me nr. rendor 8, në baze të certifikatës së regjistrimit është me lende djegëse benzinë ndërsa sipas vlerësimit është me motor dizel.

Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik. Personat juridik të cilët marrin pjesë duhet që me veti të sjellin Certifikatën e regjistrimit të biznesit, kurse personat fizik kopjen e letërnjoftimit personal. Fitues do të jetë oferta e ofruar me çmimin më të lartë. Të interesuarit mund të tërheqin dokumentacionin e ankandit-listën e artikujve në zyrën nr 1012, prej orës 08:00-16:00, ose mund të shkarkohen në web faqen e AAPSK-sc,në: <https://md.rks-gov.net/> Në zarf të shkruhet për: AAPSK, Divizioni i Shitjes; oferta mos të hapet para orës 10:00.

Adresa: Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar Ish Pallati i Rilindjes, kati 10, Divizioni i Shitjes nr. 1012, Prishtinë, tel 038 200 18 051.

**RESTAURANT**

**SWISS**  
**TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

Prishtinë

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

[www.facebook.com/gjeipuneshpejte](http://www.facebook.com/gjeipuneshpejte)

**MOMENTI YT**

Premia kryesore  
**1X BANESË**

**1X BMW X6** **3X VW T-ROC**

Ky është **MOMENTI YT** për të fituar një nga **100 MEGA-DHURATAT**, me premitë kryesore **BANESË NË QENDËR TË PRISHTINËS** dhe **BMW X6**.

Hyni në lojë tani duke aktivizuar pakon me **5GB**, duke thirrur kodin **\*100#**.  
Pako kushton 2.5 Eur dhe ka validitet 10 ditë.

Dhuratat tjera që ju presin janë: 3xVW T-ROC, 8x iPhone XS, 8x iPhone XR, 8x Samsung Galaxy Note 9, 8x Samsung Galaxy S9, 8x PS4 PRO, 8x Samsung Tablet, 4x Laptop Dell, 16x 500 €, 27x 200 €.

Përzgjedhja e fituesve do të bëhet drejtpërdrejt në programin e pasditës në **T7**, çdo dy javë duke filluar nga **12 nëntor 2018**.

Sa më shumë aktivizime të pakos që bëni, aq më shumë mundësi keni për të fituar!

